

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 239, Shtator 2023  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## U zhvillua konferenca e VII e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

2

Me datën 23 shtator 2023 u mbajt konferenca e 7-të e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Rendi i ditës ishte:

- Realizimet e shoqatës nga konferenca e 6-të deri në konferencën e 7-të.
- Zgjedhjet për kryetarin dhe anëtarët e Këshilli Shoqatës.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Anton Kosteri, sekretar i shoqatës, i cili bëri një prezantim të përgjithshëm të shoqatës, duke prezantuar edhe strukturat kryesore të konferencës. Ndër të tjera përmendi anëtarë të shoqatës që kanë ndërruar jetë ndër vite, ku u mbajt edhe një minutë heshtje në nderim të tyre. Një nga pikat kyçe të përmendura ishte edhe mungesa e disa anëtarëve të Shoqatës, të cilët jo gjithmonë janë të pranishëm në



## NIS RRUGËTIMIN E SAJ RADIO "ESENCË"

Risia nis hapësirën e re të komunikimit me publikun, në ambientet e shtëpisë së Sandrit, si një Oaz artistik që i shtohet Shkodër Loces tonë, qytetit të tij të zemrës.

Në këtë inaugurim të studios së re, Sandri bëri bashkë emra të mëdhenj të humorit, këngëtarë, poetë, simpatizantë, artdashës, shumë miq dhe bashkëpunëtor të artit dhe kulturës, por dhe mediat që vlerësuan dhe nderuan këtë nisëm të veçantë të aktorit të njohur shkodran, humoristit, Sander Ruçi, këtij mjeshtri të rrallë, me një performancë gjithnjë e më të ndritur edhe pse jeton prej disa vitesh në Jacksonville, Florida të SHBA, asnjëherë nuk i ka shkëputur lidhjet me qytetin e tij të lindjes. Duke u takuar me të gjitha kategoritë e njerëzve, ai u shpreh se, këto momente magjike që po kalon me po më zgjasin jetën, ndaj i falënderoi me shumë përlulje. ...

11

## "RRNOFTË KRISHTI MBRET"! Memoriali i 7 T'lumnuemve të Kishës Katolike Dukagjinas

7

Me datën 26 Shtator 2023 rrezet e para të diellit përshëndet vargun e gjatë të automjeteve, të cilat po udhëtonin drejt Shalës e pikërisht në Breg të Lumit, ku në oborrin e Kishës së Shën Shtjefnit martir - I mbështjell me flamurin kuq e zi do i priste memoriali me 7 emrat e t' lumnuemve të Kishës Katolike, dukagjinas.

Qelli i kaltër dhe krejt lugina e Shalës do jehonte nga zëri i kumbonve të kishave të Abatit, Gimajve, Thethit dhe Shën Shtjefnit. E magjishme kjo atmosferë, e cila lajmëronte se pas pak do fillonte festa e Bekuar. Pas mikpritjes nga banoret e famullisë dhe komisionit organizativ, në orën 11.00 filloi Mesha e Shenjtë, e cila u kremtua nga Imzot Angelo Masaffra, kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë së bashku me disa meshtarë. Në homelin e tij solli falënderimet ndaj Zotit për shembullin e T'lumnuemve dhe kërkoj ndërmjetësin e tyre për popullin e Dukagjinit dhe krejt Shqipërinë.



## Festivali i lahtarëve

Me datën 24 shtator 2023 ditën e Diele, në Studion muzikore etnografike "Besa - Shosh", me qendër në Bardhaj Shkodër u mbajt festivali mbarëkombëtar i lahtarëve shqiptar, dita e tret e edicionit të peste, me titull 'Lahuta - Okarina dhe Polifonia Shqiptare'. Qëllimi i kësaj veprimtarie është njohja ndërkombëtare e këtyre vlerave dhe dërgimi tyre në UNESCO si vlera Botërore. Dita e pare ose ndryshe hapja e këtij festivali është mbajt me datën 13 gusht të këtij viti, në Mitrovicën e Veriut të Kosovës, ku ishim edhe ne lahtarët nga Shkodra të ftuar në këtë festival. Por, manifestimi kombëtar - "Logu i Bjeshkës" në Kelmend na privoj nga pjesëmarrja për arsye se te dy këto veprimtari mbaheshin në një datë dhe lahtarët nga Shkodra ishin të ftuar në "Logu i Bjeshkës- 2023" dhe nuk morën pjesë. ...

12

# U zhvillua konferenca e VII e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

Me datën 23 shtator 2023 u mbajt konferenca e 7-të e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Rendi i ditës ishte:

-Realizimet e shoqatës nga konferenca e 6-të deri në konferencën e 7-të.

-Zgjedhjet për kryetarin dhe anëtarët e Këshilli Shoqatës.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Anton Kosteri, sekretar i shoqatës, i cili bëri një prezantim të përgjithshëm të shoqatës, duke prezantuar edhe strukturat kryesore të konferencës. Ndër të tjera përmendi anëtarë të shoqatës që kanë ndërruar jetë ndër vite, ku u mbajt edhe një minutë heshtje në nderim të tyre.

Një nga pikat kyçe të përmendura ishte edhe mungesa e disa anëtarëve të Shoqatës, të cilët jo gjithmonë janë të pranishëm në veprimtaritë e shoqatës.

Për çështjen e parë të rendit të ditës “Paraqitja realizimet e shoqatës në periudhën 2019-2023” e mbajti kryetari i saj z. Ndue Sanaj, që përmendi të gjitha arritjet e shoqatës, por edhe problematikat kryesore si: “Shoqëri Dukagjinase”, me të gjitha ngjarjet e ndodhura së fundmi, por edhe duke nxitur të rinjtë të tjerë të afrohen shoqatës, që më e rëndësishmja është motoja e shoqatës që do vazhdojë të jetë e njëjta për emancipimin.

Nga diskutimet nënkryetari i shoqatës, z. Agron Hasanaj shpallori të dhënat financiare dhe të gjithë donatorët e shoqatës ndër vite me moton e përgjithshme: “Paçin e dhënçin”. Lista e plotë e bashkëngjitur. Një falënderim të veçantë përmendi edhe për kryetarin z. Ndue Sanaj për punën e mirë dhe vitalitetin e dhënë ndër vite.

Fjalën e tij përshëndetëse e mbajti edhe konsulli i nderit të Ambasadës Austriake z. Gjergj Leqejza, i cili u shpreh: “Jam shumë i nderuar që jam anëtar i kësaj shoqate që në vitin 2004. Fillimet kanë pasur paragjykime të ndryshme, por që me punë kanë tejkaluar të gjitha pritshmërinë edhe nga çdo shoqatë tjetër në Shqipëri e më gjerë. Një ndër arritjet më të mëdha të Shoqatës është mbajtja e gazetës e vetmja në llojin e saj në të gjithë veriun e Shqipërisë. Pozitive është të përmendet se çdo gjë është bërë me baza vullnetare. Gjithashtu fakti që gjate viteve të saj janë shtuar donatorët e Shoqatës çka garanton vazhdimësinë e saj”.

Një nga të ftuarat speciale në këtë ditë ishte edhe zj. Migena Arallati nga Gjakova, poete dhe Doktoreshë e Shkencave Sociale, që në fjalën e saj përshëndetëse tha: “Sa herë që përmendet emri Dukagjin, rritet në zemër ndjenja kombëtare. Une ju komplimentoj për punën e bërë në promovimin e vlerave më të mira të Dukagjinit. Ju falënderoj për vlerësimin e bërë, sa herë të vini në Gjakovë dyert tona do të jenë të hapura”.

Gjithashtu në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i degës së Tiranës, z. Zef Bari, duke shprehur se kjo ka qenë aktive duke

tejkalar pritshmërinë dhe do vazhdojë të jetë aktive për gjatë gjithë vijueshmërisë së shoqatës, duke vënë theksin e afimit të të rinjve më shumë në Shoqatë.

Një përshëndetje u dha edhe nga poetja Feride Ramadani që u shpreh “Lum ju për shoqatën dhe të gjitha veprimtaritë që bëni. E meritoni të gjithë vlerësimin tonë. Uroj të jetoni sa më gjatë dhe suksese në të ardhmen”.

Në fjalën e tij përshëndetëse një nga aktivistët kryesorë të shoqatës poeti dhe publicisti z. Prele Milani, ku u shpreh se shoqata ka bërë shumë veprimtari ndër vite, duhet të emancipohemi dhe të bashkëjetojmë me të ardhmen, të rinjtë duhet të afrohen më shumë në shoqatë. Të luftohet diskriminimi me punë duke vërtetuar të kundërtën e paragjykimeve.

Në fjalën përshëndetëse të znjsh. Roza Pjetri tha se: “Jemi 20 vjeç, jemi në të rinisë. Gazeta duhet se s’bën të ketë vazhdimësinë e saj. Nuk duhet të mbetemi vetëm në Dukagjin, por edhe të zgjerojmë degët kudo ku ka Dukagjinas, në Zvicër, Angli, Amerike e më gjerë”.

Një ndër themeluesit e shoqatës z. Ndue Vati shprehet se ka qenë nder i madh që është nder themeluesit e saj, fakti që shoqata bën 20 vjeç, na rrit përgjegjësinë të punojmë akoma më shumë.

Pas të gjitha fjalëve përshëndetëse është momenti kyç i konferencës që janë zgjedhjet.

Drejtimin e merr komisioni i përbërë nga znjsh. Roza Pjetri, z. Aleks Dushi dhe z. Kole Vladaj.

Komisioni shprehet se e vetmja kandi-

daturë e mbërritur është përsëri për kryetarin aktual. Nga diskutimet me votim të hapur u vendos që në baze të statutit të shoqatës edhe për 5 vite e ardhshme kryetar të vijojë të jetë z. Ndue Sanaj.

U votua gjithashtu me votim të hapur edhe për anëtarët e Këshillit të shoqatës të propozuara nga kryesia. Anëtarët e kryesisë u zgjodhën: Agron Hasanaj, Edmond Terthorja, Mikel Kopsaj, Anton Kosteri, Tonin Marku, Diana Bungu, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Suela Ndoja, Fatmir Vojvoda, Martin Ahi, Arbër Shytani, Ndue Vata, Kole Çardaku, Roza Pjetri, Viola Shqau, Martin Arra, Gjon Fierza, Luigj Shyti, Marjana Koçeku, Moter Dukate Radoja, Kole Sukullari, Niko Marku, Gjergj Leqejza, Prele Milani, Lazer Kodra, Arbër Raja, Dukate Bregu, Getjan Gropaj, Ledia Dushi, Viktor Arrinaj dhe dr. Ndue Nikaj, Leze Bungaja dhe Erida Delia.

Fjalën përshëndetëse të mbylljes e mbajti kryetari z. Ndue Sanaj, duke falënderuar për besimin, por duke u shprehur se duhen të rinj me vizione të reja për shoqatën.

\*\*\*

Organizimi, për përgatitja e zhvillimi i Konferencës u mundësua nga Viktor Arrinaj, Mhill Shkami, Kole Sukullari, Vilson Peshkaj, prof.dr. Vuksan Kola e Kole Çardaku, të cilët i falënderojmë me shprehjen popullore: Paçin e dhënçin!

\*\*\*

## Telegrame Urimi:

**Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” në Pejë.**

Në emër të Shoqatës “Martin Dreshaj” ju uroi suksese në Konferencën e VII të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në Shkodër, dhe shprehim gatishmërinë tonë për bashkëpunimin vëllazëror në veprimtaritë kulturore atdhetare.

Suksese dhe na prift e mbara!.

Me respekt:

Kryetari i Shoqatës “Martin Dreshaj” në Pejë, Ukshin Jashari.

Lëvizja për Shqipëri të Bashkuar, me qendër në Pejë:

Në emër të Lëvizjes për Shqipëri të Bashkuar ju uroi suksese në Konferencën e VII të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në Shkodër, dhe shprehim gatishmërinë tonë për bashkëpunimin vëllazëror në veprimtaritë tona të përbashkëta kulturore e atdhetare në realizimin e misionit tonë në Lëvizjen për Shqipërinë e Bashkuar!

Suksese dhe na prift e mbara!

Kryetari i Lëvizjes për Shqipëri të Bashkuar, Frashër Racaj

**KLODJANA SERRAJ**



# PARAQITJA e REALIZIMEVE, NGA KONFERENCA E VI DERI NË KONFERENCËN E VII

- Domosdoshmëri e ecurisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" në vijimin e realizimit të MISIONIT të saj, në emancipimit shoqërore të bashkësisë dukagjinase -

Të nderuar delegate të Konferencës së VII të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Të nderuar miq!

Vijmë në konferencën e VII me realizime jo të pakta. Ne, vijuan të ecim moton e themelimit të Shoqatës "Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çfarë bëra unë për Dukagjinin!"

Në këto arritje, është mendimi dhe mundi i anëtarëve të shoqatës, i juaj dhe në veçanti i anëtarëve të kryesisë, për të cilën ju falënderoj dhe ju jemi shumë mirënjohës. Ju jemi shumë mirënjohës, jo se nuk është detyra e anëtarit të shoqatës të punojë, jo se nuk është detyra e anëtarit të kryesisë të punojë, por duke qene gjithçka vullnetare, gjithçka pa shpërblim, mirënjohja është më e thellë, më e plotë, mirënjohja është më shpresdhënëse për të ardhmen e ecjes më tej të Shoqatës.

Një falënderim i veçantë vjen dhe për shoqatat analoge, si "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë; "Dita e Plisit", me qendër në Klinë, Ansambli "Rugova", me qendër në Pejë, "Mikaj Merturi", me qendër në Tiranë, "Xhubleta e Alpeve Shqiptare", me qendër në Bajze të Malësisë së Madhe, "BYtyçi", "Besa Shoshi" dhe të tjera, të cilat me bashkëpunimin e tyre të vijueshëm kanë ndikuar në ecjen pa u ndalur për realizimin e misionit të Shoqatës.

Delegatë, miq!

Në arritjet e këtyre pese viteve, është dhe kontributi i pushtetit vendor, i bashkisë Shkodër, i Qarkut Shkodër, i Prefekturës Shkodër, i njësive administrative, të cilët na pranuan për të bashkëpunuar, na kane mbështetur deri në strukturat më të larta të Shtetit, pa të cilën ndoshta disa arritje nuk do të ishin sot prezent në këtë konferencë.

Më lejoni, që në këtë konferencë të paraqes disa arritje në këto 5 vite:

**Së pari**, Kryesia e Shoqatës pasi vendosi të nxjerre gazetën e pagëzuar me emrin "Dukagjini", e cila që nga numri i pare, në dhjetor 2003 e deri më sot nuk është ndalur. Në këtë fund muaji del numri 239 i saj, fale përkushtimit të redaksisë së saj e drejtuar nga Prele Milani, Lazer Kodra, Suela Ndoja dhe së fundi nga Luigj Shyti, që nga Australia e largët, SHBA, shtete të ndryshme të Evropës, dhe të hapësirave shqiptare, që nga Kosova Lindore e deri te Rrozhaja, që nga Saranda e deri te Peja e Tuzi, me plote 611 autore, me 3 479 artikuj të ndryshëm. Realizimi i botimit të gazetës "Dukagjini" nuk do të ishte arritur pa kontributin financiar të 102 dukagjinave, me një vlerë prej 5 054 742 lekë, por kryesisht të Gjergj Leqezes, të Ndue Ftonit, të Mhill Prronit, Agron Hasanaj, Anton Kosteri, Kujtim Funiçit dhe të tjerëve. Viti i XX i botimit të saj, u festua me datën 30 dhjetor 2022, në mjediset e Bar-Restorant "Tradita", me mbështetjen e zotit Gjon Dukgilaj dhe të Anton Kosterit, Kole Çardakut, Pal Shkambit, Florenc Buzhes e Mark Micit. Vetëm në këtë

pesë vjeçare, 2019-2023 kanë mundësuar botimin e gazetës 45 persona, më në krye Kujtim Funiçin, Anton Kosterin, Agron Hasanin, Petrit Sokoli, Lazer Kulla e të tjerë, gjithsejtë me 1 168 500 leke, të cilët i urojmë: "Paçin e dhënçin!"

Mirënjohje për të gjithë ata që morën

Së teti, një veprimtari e veçantë, me datën 13 mars 2022, në mjedisin e shkollës "Edith Durhami", në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare në lagjen "Mark Lula", në Bardhaj, në Hot të Ri, në Grudë të Re, në Vrake; "Martin Camaj" në Shkodër; "Zemra e Krishtit" dhe "Dëshmoret e

tat analoge, jemi nderuar me tituj nderi: "Mirënjohja e Shoqatës së vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, për pjesëmarrje në Manifestimin "Zëri i vëllazërisë", në vitin 2019, 2011, 2020, 2021, 2022 e 2023; me rastin 20 vjetorit të Themelimit të SHAD



kohë nga koha e tyre e çmuar dhe menduan, punuan e futen mendjen në punë për të qenë pjesë e gazetës "Dukagjini"!

**Së dyti**, në këto pesë vite janë realizuar apo marre pjese në 52 veprimtari, mesatarisht 10. 4 veprimtari në vit dhe në mes tyre janë paraqite 12 libra.

**Së treti**, në këto pese vite, janë dekoruar personalitete e figura të rëndësishme në jetën e bashkësisë dukagjinase: Kantautori Mhill Çuni, me urdhrin "Mjeshtër i Madh", këngëtarja e aktorja Rita Ndoci, me urdhrin "Mjeshtër e Madhe", Dom Prek Ndrevasaj, me titullin "Kalorësi Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" dhe zoti Gjergj Leqezja e Luigj Mila nga Këshilli i Qarkut Shkodër nderohen me titullin e larte "Krenaria e Qarkut Shkodër".

**Së katërti**, me datën 20 mars 2023, nga një grup i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ishte një takim i veçantë me Presidentin e Republikës, zotin Bajram Begaj, i cili u nderua me logon e shoqatës dhe ju dhuruan disa libra nga Zef Gjeta, Prele Milani e Luigj Shyti.

**Së pesti**, në muajin janar vitin 2022, në teatrin "Migjeni", u zhvillua ceremonia e Natës Finale e personaliteteve të vitit 2021 për Shkodrën dhe historiani, shkrimtari e publicist Prele Milani, shpallet shkrimtari i vitit, për vitin 2021.

**Së gjashti**, me datën 27 prill 2022, në takimin: Unioni i gazetarëve shqiptarë, Qarku Shkodër, në edicionin e pestë, -Gazeta "Dukagjini" u nderua me çmimin "Hamit Boriçi",

**Së shtati**, Kryeredaktori i pare i gazetës "Dukagjini" dhe publicisti i njohur, Prele Milani, nderohet me i Çmimin "Hamit Boriçi", në edicionin e 6-të.

Prishtinës", në shkollat e njësive Administrative Shalë, Shosh e Pult, apo ndonjë tjetër shkolle të veçantë, organizuam takimin me nxënës të klasës IX të shkëlqyer, me teme: "Shkollimi e edukimi janë çelësi i emancipimit të shoqërisë sonë", dhe këta nxënës e disa mësues u nderuan me titullin "**Mirënjohja mësuese Kushë Micja**", mësuesja e pare dukagjinase në Shkodër, që ngriti shkollën e pare femërore në qytetin e Shkodrës, në vitin 1859.

Në këto pese vite, arritjet përkatëse nuk mund të ishin realizuar pa kontributin financiar të 104 mundësorëve, me një vlere të përgjithshme 1 749 355 leke, që 45 prej tyre kane dhanë kontributin financiar për botimin e gazetës "Dukagjini", dhe 59 vete kane dhanë kontributin për përgatitjen e realizimin e veprimtarive të shoqatës, me një vlere prej 847 355 leke.

Të gjithëve ju urojmë, me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Në gjithë këto vite, prej 5 viteve, Kryesia e Shoqatës ka nderuar me tituj nderi 226 persona të fushave të ndryshme, në mes tyre 63 femra. Në mes tyre kemi 25 persona "Anëtar Nderi të SHAD", 12 persona "Nderi i SHAD", 11 persona renë dëshmorë, janë nderuar me titullin "Mehmet Shpendi", 11 persona, shkrimtar, artist, poet, janë nderuar me titullin "Mirënjohja Martin Camaj"; 121 persona "Mirënjohja e SHAD" dhe 46 persona "Mirënjohja mësuese Kushë Micja". Pra, kemi bere përpjekje të nderojmë gjithë ata, jo vetëm dukagjinase, por dhe nga hapësirat e tjera shqiptare, që kane dhënë shoqërisë, që i kane dhënë kombit tone.

Në këto vite për kontributin që kemi dhënë, për bashkëpunimin me shoqa-

nga shoqata "Martin Dreshaj" janë dhanë titulli "Anëtar Nderi i Saj" po të thuash të gjithë anëtarëve të kryesisë.

Të nderuar delegat!

Të gjithë këto arritje dhe nderime në këto 20 vite, janë "prone" vetëm e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Ajo, në jetën e saj 20 vjeçare ka marre 276 vendime, për të cilat nuk ka rendësi se, cili apo cila i ka shkruar, e rëndësishme është se ato vendime i kane marre strukturat vendim-marrëse të Shoqatës, në veçanti Kryesia e Saj. Vendim i pare i saj është Themelimi i Shoqatës dhe ka vijuar me vendimin për miratimin e Statutit të saj, me vendimin e miratimit të Programit të saj, me vendimin për nxjerrjen e gazetës, miratimin e përbërjes së redaksisë. Dhe ka vijuar me vendime të tjera të rëndësishme në jetën e saj. E theksoj këtë, se kohet e fundit ka zëra, për tu bere "pronar" i njërës apo tjetrës arritje të Shoqatës.

Të nderuar delegate!

Të nderuar Miq!

Shoqata në këto vite nuk ka bërë ndonjë shpikje shkencore të veçante, apo të ketë pushtuar ndonjë maje, por ka arritur që sot të kemi një moral tjetër, gjerat ti shikojmë më me optimizëm drejt emancipimit të shoqërisë, drejt shoqërisë së hapur, në themel së cilës janë vlerat e individit, por dhe roli i individit dhe i bashkësisë të ecin në unitet me njëra-tjetrën.

Në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës dhe me miratim të Kryesisë së Saj, në këtë Konferencë pune do të ndalemi në disa probleme që na kane shqetësuar në këto vite jete të saj:

**Së pari**, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka punuar në baze të një statuti, në të

cilin janë të përcaktuar detyrat e të drejtat e secilit anëtarë të shoqatës, të secilit anëtarë të strukturave drejtuese. Por, nga disa anëtarë të shoqatës, kërkesat e statutit nuk zbatohen. Më e keqja është se, ketë problem e kemi ngritur dhe në raste të tjera, duket se, ose ne nuk kemi ditur të kërkojmë, të organizojmë, ose disa anëtarë të shoqatës kanë ardhur në shoqate për "luks" dhe ne kemi renë në prehrin e tyre, në veçanti kryetarët e degëve. Në nenin 7, përcaktohet: "... Kuota vjetore do të jete 1 000 leke në vit ...". Çfarë ka ndodhur? Kane paguar kuotën në tërësi anëtarët e kryesisë, në këto pese vite rreth 12 % e anëtarësisë. Kjo donë të thotë: Nga rreth 270 000 leke mesatarisht të arkëtohen në vit nga kuota e anëtarësisë, me të cilat shoqata do të kishte një zyrë pune, e cila tani është bërë e domosdoshme, mund të botoheshin 1-2 libra në vit, ndoshta dhe ndonjë numër gazete, janë arkëtuar mesatarisht rreth 4 450 leke në vit. Anëtar shoqate duhet të jete vetëm ai që zbaton kërkesat e statutit.

*Së dyti*, në nenin 3, përcaktohet: "Degët e shoqatës krijohen mbi baze rrethi, ... në hapësirat shqiptare ... dhe në diasporë, kur ka mbi 8 vete. Ato derdhen në llogarinë e shoqatës 50 % të të ardhurave të tyre që sigurohen sipas statutit, pjesa tjetër përdoret për nevojat e degës .... Kur veprimtaria e degëve është në kundërshtim me statutin dhe ligjet në fuqi, Kryesia e shoqatës thërret Konferencën e Përgjithshme të jashtëzakonshme dhe merre masa deri në ri-regjistrimin e degës". Ky nen i statutit nuk zbatohet nga degët, me përjashtim të degës së Tiranës. Prandaj degët duhet të riorganizohen dhe të fillojnë nga puna. Punën do ta fillojnë duke u orientuar nga statuti e programi i përgjithshëm i shoqatës në kushtet e tyre specifike se, secila dege ka specifikën e vet.

*Së treti*, Shoqata nuk është krijuar të pengojë bashkëpunimin në mes dukagjinave, përkundrazi, ti bashkojë ata, për ti dhënë emrin që meriton Dukagjini. Të ndare, të përçarë nuk mund të zësh vendin që të takon.

Ne, duhet ta respektojmë të kaluarën, ta studiojmë dhe të përgjithësojmë vlerat që duhet t'u trashëgohen brezave. Ne, nuk duhet të ecim me mendime orientale, të cilat po na ndajnë nga njeri-tjetri, duke vu në mes të këtij bashkimi "UNIN". Mentaliteti oriental, ka "PERJASHTIMIN". Kjo do të thotë, kush nuk është në një mendje me mua, përjashtohet, është armiku i im dhe si i tillë duhet të asgjësohet. Kjo nuk është tradicionale, nuk është fetare, nuk është ligjore. Si është e mundur, që Malësia e Madhe, Nënshkodra, Bregu i Matës kanë ndryshuar ritet mortore, ndërsa ne dukagjinat vijojmë! Pse? Ne, nuk po zbatojmë ato që kemi trashëguara, por i kemi thelluar keqas?! Mos valle, kush ka të drejtë? Kemi ne, apo banoret e krahnave fqinj? Secili nga ne, në ketë Konferencë dhe jashtë saj, do të thotë: "Ne nuk kemi të drejtë!"

Si është e mundur, që ende vijojmë të vrasim?! Ne dukagjinat, a besojmë në fenë katolike? Po! Ai njohim 10 urdhni-

met e Tenzot, që në urdhnim e peste, theksohet "... mos vra se, me Tenzonë hynë në gjak ...!" Po, themi. Pse kërkojmë të zgjidhim ketë fenomen me metoda arkaike, kur është shteti i demokracisë? Një qëndrim i tillë, është i papranueshëm. Mund të ketë dhe të tjera problematika, me të cilat duhet të punojë shoqata nëpërmjet formave të veta, që të ndikojë sa më shumë në emancipimin e shoqërisë. Pa punuar në këto drejtim me të gjithë strukturat dukagjinase, shoqata, Njësia administrative, arsimtari e të tjerë, më në krye intelektualët dukagjinat, duke bashkëpunuar edhe me intelektualët shkodrane, tiranas apo më gjere, nuk mund të realizojmë misionin e shoqatës. Intelektualët dukagjinat, nuk duhet ta quajnë të zgjidhur problemet, pse vete kanë zënë ndonjë vend pune të mirë. A duhet të themi, se ku janë anëtarët e

Pasi qenka mrekullia e Botes, pse e keni lanë dhe keni marre rrugët e botes? Pra, duhet të largohemi nga emocionet dhe të jetojmë me konkretën, se vetëm ajo të bën të ecësh përpara. Çdo hiperbolizim të vlerave, kthehem në primitiv.

Këto janë disa nder problemet, që shoqata në bashkëpunim me intelektualët dukagjinat, shkodrane e mbare shqiptar, me strukturat e pushtetit vendor dhe atij arsimor, duhet të punojë më me përgjegjësi për të ardhmen.

Prandaj, besojmë, se kjo konferencë me diskutimet tuaj, me vendimet e saj, do të ndikojë në reformimin e mëtejshëm të strukturave të Shoqatës, me qellim, që të gjithë të jene aktiv e më të përgjegjshëm ndaj misionit të saj.

Në cilësinë e kryetarit të Shoqatës, në emër të kryesisë së saj, duke u bazuar në

të Statutit. Nuk mund të jesh anëtar apo anëtare shoqate, në qoftë se nuk je aktiv, në qoftë se nuk paguan detyrimin fillestar, atë të kuotës, e cila paguhet brenda muajit janar të çdo viti.

4- Kryetarët e degëve, degët në tërësi, nga të cilat përbëhet Shoqata, duhet të jenë aktive. Nuk mund të jete degë, një degë, që jo vetëm nuk kujdeset për mbledhjen e kuotave, por as nuk mblidhet një herë, nuk organizon asnjë veprimtari.

5- Në të ardhmen duhet të punojmë më shumë për të afruar e për të komunikuar me intelektualët e biznesmenët dukagjinat dhe më gjere. Ne, nuk kemi kryer si duhet detyrën për të afruar intelektualët e biznesmenët, por dhe disa prej tyre nuk na janë afruar, kanë mbajtur qëndrim indiferent. Gjithsesi përgjegjësia është e jona. Nuk mundet pa ata, Shoqata të ketë mundësi të realizojë misionin e saj.

6- Plani orientues i veprimtarive të Shoqatës për pese vitet e ardhshme mund të jete:

\*Vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini", me 16 faqe, **e vijueshme, redaksia ...**

\*Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Rajonit, dhe propozimi i masave konkrete strukturave përkatëse, për ndryshimin e gjendjes, **vitin 2024, Kryesia**

\*Përgatitja e zhvillimi Konferencës shkencore, me teme: "Emancipimi shoqëror i bashkësisë dukagjinase, domosdoshmëri e kohës dhe roli i Shoqatës në realizimin e tij", **në vitin 2025, kryesia**

\*Studimi i objekteve historike të zonës së Dukagjinit, organizimi i zbulimeve arkeologjike, dhe dalja një here e mirë nga mendësitë primitive, **në vitin 2026, seksioni i historiografisë**

\*Përgatitja e zhvillimi i një shëtitje turistike me studente të fushave të ndryshme, kryesisht histori, etnografi, gjeografi e

të tjera, **në vitin 2027, seksioni i historiografisë**

\*Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge dhe zgjerimi i veprimtarive në hapësirat shqiptare, **sipas rastit, seksioni i veprimtarive**

\*Përfundimi i rindërtimi i monumentit të albanologut Martin Camaj dhe rinaugurimi i tij, me rastin e 98 vjetorit të lindjes së tij, **brenda vitit 2023, Kryesia**

\*\*\*

Këto propozime, sigurisht kanë një kosto jo të vogël, e cila mund arrihe deri në 5 158 000 leke, por si deri tani dukagjinat kudo janë do të jenë përsëri bujar për të kontribuar në realizimin e tyre, si një domosdoshmëri e kohës.

Ju faleminderit për vëmendjen që më kushtuat!

**Ndue Sanaj,**  
**Kryetari i Shoqatës Atdhetare**  
**"Dukagjini"**

Shkodër, më 23 shtator 2023



Këshillit të Bashkisë Shkodër, dukagjinat, që nuk ju dëgjohet zëri? Ne, vërtetë jemi dukagjinat dhe e ndjejmë veten krenar, por nuk mjafton kjo. Duhet punuar për të merituar veten dukagjinat. Është lehtë të themi: "Dukagjini krenaria ime!", dhe në fakt, jo pak prej nesh çdo ditë veprojnë kundër vlerave dukagjinase. Dukagjini nuk është epiqendra e shqiptarisë. Ai është pjesë e shqiptarisë, e asaj pjesë që ka dhënë dhe jep kontributin e vet në ketë nacionalitet dhe kaq. Po, hipe më larte, nuk merret kush me ty. Në qytetin tonë të Shkodrës, asnjë biznes sa do i vogël nuk është i pagëzuar me emrin "Dukagjini"! Pse? Pra, nderimi ndaj Dukagjinit dhe të të pareve matet me punën, me kontributin që jep secili dhe jo me fjalë. Në Nju-Jork është dyqani, me emrin "DUKAGJINI\_Byrektorë", por ai është nga Rrafshi i Dukagjinit.

Vjet, me 30 prill u bë një takim mjaft serioz nga shoqata "Emigranti për vendlindjen", të cilët kontribuan mjaft për ti dhanë vlera krahnës se tyre, Shalës, por në ligjërimet e disa prej tyre Shalën e Dukagjinit i ngritën aq lart, sa i bën mrekullia e Botes?! Lind pyetja e thjeshte:

arritjet dhe në mos arritjet, në përparimin shoqëror që është bërë, por dhe në mendësitë orientale, primitive, që shfaqen here pas here dhe jo pak po na pengojnë të ecim përpara, ju propozoj:

1-Misioni i Shoqatës të mos ndryshojë: "Misioni i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të vijojë edhe në ardhmen "**Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinave kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejte standardeve evropiane**".

2-Mbledhjet e Përgjithshme të degëve, të bëhen brenda muajit nëntor 2023 dhe me ata anëtar, që do të marrin pjesë në këto mbledhje, duke përjashtuar arsytet madhore, të hapet regjistri i ri anëtarëve të Shoqatës në baze dege dhe mbi bazën e tyre të rihapet ai, në baze të Shoqatës. Mbi bazën e këtij regjistri, ndoshta lind nevoja të freskohet dokumenti i anëtarësisë në shoqatë.

3-Të rritet përgjegjësia e secilit anëtar të shoqatës, në zbatimin e kërkesave

# Të vijomë të bëjmë përpjekje, të lemë vlera për brezat

Të nderuar delegate të Konferencës së VII të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Tjeta juej!

Sot, jemi mbledhur këtu për pasionin dhe dëshirën tone të përbashkët për të mbrojtur dhe avancuar trashëgiminë tone të pasur kulturore, historike dhe natyrore të Dukagjinit.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", është një familje e madhe e burrave dhe grave, që ndajnë një synim të përbashkët- ruajtjen e vlerave tona dhe promovimin e identitetit tone Dukagjinase.

Jemi krenar për vendlindjen tonë dhe traditat tona, që kane kaluar brazë pas brezi. Qëllimi jone është të lemë gjurmë kryesisht tek brezi ri ta duan edhe me fort Dukagjinin.

Përmes veprimtarive tona, kujtojmë ngjarje të rëndësishme të historisë tonë,

prezantojmë ngjarjet artistike, promovojmë turizmin dhe kontribuojmë në zhvillimin e bashkësisë sonë.

Në burim informacioni dhe komunikimi është Gazeta Dukagjini që prej vitit 2003, e cila publikohet fal kontributit të vullnetar çdo muaj dhe në fund të këtij muaji botohet nr. 239.

Realizimi i botimit të gazetës "Dukagjini" nuk do të ishte arritur pa kontributin financiar të 102 dukagjinaseve, me një vlerë prej 5 054 742 lekë.

Dukagjini është më shumë se një vend, është një ndjenje, një pasion dhe një kujtim i vijueshëm për gjeneratat e kaluara dhe për ato që do vijnë. Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur dhe ndërtuar trashëgiminë tonë.

Bashkangjitur është tabela e mundësorëve për vitet 2019-2023 në jetën e



Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vijueshme në Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" për realizimin e misionit të saj!

Së bashku, mund të bëjmë ndryshime pozitive dhe ta lemë këtë trashëgimi të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Prandaj biznesmenët dukagjinase kudo janë i ftojmë, që si deri më sot të vijojnë të behën pjese e jona!

Faleminderit!

**Agron Hasanaj,**

N/kryetari i SHAD, 23 shtator 2023

## Tabela e mundësorëve për vitet 2019-2023

N/r	EMERI MBIEMRI	Vitet					Shuma
		2019	2020	2021	2022	2023	
1	Anton Kosteri	26500	15500	10000	20500	50500	123000
2	Mark Maraçaj	10000	0	0	0	0	10000
3	Mikel Kopsaj	5500	0	0	0	0	5500
4	Vilson Peshkaj	5000	0	0	0	2000	7000
5	Prel e Mri Kroj	10500	0	0	0	5000	15500
6	Fran Fusha	10000	0	0	0	0	10000
7	Pëllumb Shqau	20500	0	0	0	0	20500
8	Donika e Agim, Martini Gila	20500	20500	0	0	0	41000
9	Lulash Gjeloşi	20500	0	0	0	20500	41000
10	Kole Çardaku	51500	0	0	10000	10800	72300
11	Pale Shkëmbi	10000	0	0	10000	0	20000
12	Agim Dardha	20500	0	0	0	0	20500
13	Alfred Zef Bari	20500	0	0	0	0	20500
14	Pjeter Gjeta	20500	0	0	0	0	20500
15	Sokol Cubi	30750	0	0	0	0	30750
16	Agron Hasanaj	2000	20500	30500	22500	0	75500
17	Gjergj Leqejza	20000	41000	22000	16000	25000	124000
18	Edmond Terthorja	20000	0	0	0	20000	40000
19	Ndrek Guri	8000	0	0	0	0	8000
20	Tonin Marku	5000	0	0	0	0	5000
21	Mhill Prroni	10000	0	0	0	0	10000
22	Kujtim Funiçi	0	44000	50305	0	0	94305
23	Ndue Nika	0	10000	0	0	0	10000
24	Zef Nika ...	0	20500	0	0	0	20500
25	Luigj Temali	0	1000	0	2000	0	3000
26	Klodjana Serraj	0	2000	0	0	0	2000
27	Gjergj Guri	0	21000	0	0	0	21000
28	Pjeter Gera	0	1000	0	2000	0	3000
29	Motra Dukate Radoja	0	10000	0	0	0	10000
30	Sokol Sterbyqi	0	16000	24704	0	18928	59632
31	Preke Gjonaj	0	40000	24704	10000	18929	93633
32	Bar-Restorant "ELITA"	0	20500	0	0	0	20500
33	Nikolin Gjeloşi	0	24600	0	0	0	24600
34	Fran Shytani	0	20500	20500	0	11000	52000
35	Edmira e Luigi Mazzo	0	0	20500	0	0	20500
36	Mhill Shkambi	0	0	20500	0	30000	50500
37	Tome Arra	0	0	20500	0	20500	41000
38	Agostin Aramadhi	0	0	20500	0	0	20500

## SHOQATA ATDHETARE "DUKAGJINI" KRYEFJALË PËRBASHKUESE HISTORIKE JO NËMË OTOMANISTE E MOHIMIT MOHOR



Sot është Konferenca e VII-të e shoqatës së shumë dëshiruar që themeluam, morëm për dore dhe e ngritëm në podin me prestigjioze të hapësirës shqiptare. Në hapat fillestare as nuk e imagjinoi se do arrinin kaq lart e kaq larg. Gjithsesi jemi te vetëdijshëm se nuk kemi bere mrekulli, madje as çerekun e asaj që dëshironim, por po me të mirën e mundshme po. Vitet kanë bërë punën e tyre disa aktivist na i mori rrjedha e moshës, disa te ri i rriti, disa nga ne na poqi e disa te tjerë i ka çuar tek portat e moshës së tretëm. Vetëm misioni i shoqatës edhe pas 20 vitesh mbetet i po ai i ri vital dhe nuk duhet të njohi moshë në

39	Shan Staka	0	0	20500	0	0	20500
40	Vate Dema	0	0	20500	0	0	20500
41	Mirash Lallinaj	0	0	8235	0	0	8235
42	MiraLuvigj Lallinaj	0	0	8235	0	0	8235
43	Kristian Qershia	0	0	8235	0	0	8235
44	Besnik Arrinaj	0	0	8235	0	0	8235
45	Nikolle Gerla	0	0	8235	0	0	8235
46	Angjelin Rashkadoli	0	0	8235	0	0	8235
47	Arben Toma	0	0	4117	0	0	4117
48	Marjan Ndershtiqani	0	0	5000	0	0	5000
49	Luigj Shyti	0	0	2000	0	0	2000
50	Genc Çardaku	0	0	5000	0	0	5000
51	Shitija Gazete	1900	0	3295	0	0	5195
52	Nikë Marku	0	0		20500	0	20500
53	Ermal Shytani	0	0		20500	0	20500
54	Gjergj Demaj	0	0		20500	0	20500
55	Dede Prendaj	0	0		20500	0	20500
56	Aleks Martin Bardhoja	0	0		2000	24500	26500
57	Sokol Dedevekaj	0	0		20500	0	20500
58	Lazer Kulla	0	0		41000	0	41000
59	Petrit Sokoli	0	0		20500	21000	41500
60	Lalash Ara	0	0		20500	0	20500
61	Mark Mici	0	0		5000	0	5000
62	Florenc Buxha	0	0		0	11000	11000
63	Pal Lera	0	0		0	29700	29700
64	Nikolin Kulla	0	0		0	20500	20500
65	Kole Sukullari	0	0		0	61500	61500
66	Engjëll Radohima	0	0		0	50000	50000
67	Viktor Arrinaj	0	0		0	70000	70000
68	Roza Pjetri	0	0		0	10000	10000
69	Agim Hasanaj	0	0		0	25000	25000
70	Gjon e Rajmonda Dukgilaj	0	0		0	10000	10000
71	Prelë Milani	0	0		0	10000	10000
72	Vuksan Kola	0	0		0	25000	25000
	<b>Shuma</b>	<b>349650</b>	<b>328600</b>	<b>374535</b>	<b>284500</b>	<b>601357</b>	<b>1938642</b>

shtegtimin e vet. Shpesh here sehirxhitë e jashtëm i ka shqetësuar bindja, besimi dhe përkatësia jonë e cila as një herë nuk ka qenë çështje për ne. Pavarësisht idealizmit, vullnetarizmit, patriotizmit, po të futej në rend të ditës së punëve tona politika dhe feja do ishim rrëzuar e llucosur mes baltës. Kanë te drejtë ndërprerues ata thanë se edhe pas 20 vitesh shoqata vijon po thuaj me te njëjtin staf drejtues qe motit kur filloi maratonën. Po të arsyetonin pak më hollë do bindeshin vetëvetiu se bërthama e moçme është kyçi i gjitha suksesëve te shoqatës sonë, pasi kanë ditur të bashkëpunojnë dhe shtrinë krahët e bashkëpunimit në një rrafsh shumë më të gjerë se gjeografia e Dukagjinit tonë. Po të jemi pak koherent jo vetëm Shoqata Atdhetare "Dukagjini", por gjithë shoqëria shqiptare është e kërcënuar nga dhëmbët e një kapitalizmi të egër plaçkitës, qe pjellë viktimë, përçarje, grykësi, ekstravagancë, individualizëm ekstrem, çroditje, antivlera qe serviren si vlera, krim vrasje, drogë, prostitucion, rrënim shpirtërorë dhe kthimin e gjithçkaje ne mall dhe përfitim. Kush e duartroket këtë kapitalizëm aq më tepër e proklamoi si demokraci ose është i dehur ose lajkatarë sahan lepires. Sot është

vështirë të gjesh dhe akoma më vështirë të bashkohesh dhe aktivizosh një masë njerëzish social që punojnë për idealizëm



si dy brezat e deri sotëm bazik të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Imigracioni masiv i të rinjve, gjendja e pa sigurt dhe pa shprese është epidemia rrënimtare, për shoqërinë tonë. Edhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ndien dhimbjen shytuese te kësaj plage vrastare. Shqipëria është në rendje te lire drejt një plakje galopuese. Ne si shoqatë akoma nuk jemi plakur, por duke qene se prurjet e reja janë më të vogla se brezi i dytë ka

vend për alarm, po, po për alarm kushtrimues. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka qenë është e do te jetë rrufepritësja

më e mirë ndaj ligësive orientaliste, diskriminues të atyre që nuk shohin trarin e tyre dhe qime dukagjinase e bëjnë tra e mizën buall. Të shartuarit, të pa rrënjëtë, të shtruarit si bari nënë kosë apo koret e kumjaçkave neotomaniste te shoqata atdhetare "Dukagjini" do të gjejnë një barrikadë të pa kapërcyeshme mirësie, atdhetarie, bujarie, culture, vizioneve e progresiste.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" është

çikë dëshirit e atashit tonë të vjetër shpatullgjere dhe një nga gjymtyrët më të thukta kombëtare. Detyra dhe misioni jonë është gjurmimi ndriçimi dhe përfrim duke shkapercyer suazat e ngusha locale, duke u kujtuar dukagjinasve të mbetur pa dukagjin se, ky me emër është kryefjalë e gjerë përbashkuese historike jo nëmë otomaniste e mohimit; mohor.

Traseja shinat. lokomotiva dhe vagonët e shoqatës Dukagjini janë në punë efçete. Lëvizja duhet te vijoi me mashinist të vjetër apo te ri. Treni done, duhet ta kapin edhe te rinjtë edhe gratë. Ju bej thirrje publike mësuesëve tona të mira tashme nena të pjekura edhe bashkëshorte, gra shembullore si Shpresa Ftoni, Age Villi, Tereze Brigja, Tule Ahu, Drita Zefi, Tringa Shytani, Luljeta Shyti, Marie Logu, Diella Vuksani, Dalina Arra, Manushaqe Vojvoda, Marie Musa, Vitore Ara, Prende Rreshpja e të tjera, Ju duhet te jeni pjese aktive jo figurante dhe ftuara si deri me sot. Një veprimtari ne dy muaj nuk paraqet as një kohë humbje te madhe për një mësues, por e kundërta paraqet mangësi mos pjesëmarrja juaj ashtu siç duhet merri vete përsipër, se çfarë do beni vetë e te mos prisni nga "partia"

Sot ka plot mjete të tjera transporti dhe gjithkush mund te gjej zgjedhjen e tij të preferuar, por Shoqata eshte një lokomotive me motor te ndezur promatore e vlerave me të mira dukagjinase. Do ishte dështim te përfundonte në një kamion apo auto veturë, por edhe utopi të mendohej se do fluturonte e behej balonë. Gazeta është truri dhe panorama e shoqatës, kanë lindur një herazi dhe bashke duhet te udhëtojnë dorë për dore. Gazeta ndonëse është zëri më i rëndësishëm i shoqatës mbetet me e "diskriminuara" mes nesh. Akoma nuk eshte siguruar një bord as një fondi te paktën (tre ditë pune sa një të pastruesje) e ati qe merret me përgatitjen për botim. Kemi shpenzuar energji për folklorizma edhe për gjera të stomakut dhe kemi lënë gazetën si një grua të bukur me këpuce e çorape të grisura, duke dhënë rast dashakëqive të na kritikojnë për çdo birë gardhi edhe ato që nuk duhej ti kishte gazeta jonë.

Shoqata duhet te mbetet përfaqësuese e vlere me të larta intelektuale e krijuese të Dukagjinit, larg arkaizmave tradicional, krahinizmave fisnorë flamujve te grisur te bajraqeve dhe bajraqeve te ndyra te politikës, larg egove dhe smirëzisë së sëmur feudale.

Shoqata si deri më sot kurër nuk duhet te behet tupan sharjesh dhe mllfesh të as një lloj as intrige politike, regjionale, klasore as krahinore.

Shoqata duhet te mbaj me guxim harkun dhe shigjetën syzuese të "Odiseut" ndaj çdo diskriminimi që behet kujdo në këtë vend me psikologji larushane nga orientalizmi fanatik deri tek anarkia "moderniste" e mbarsur me veset me të liga te kohës moderne.

**PRELË MILANI**

# “RRNOFTË KRISHTI MBRET”!

## Memoriali i 7 T'lumnuemve të Kishës Katolike Dukagjinas

Me datën 26 Shtator 2023 rrezet e para të diellit përshëndet vargun e gjatë të autometeve, të cilat po udhëtonin drejt Shalës e pikërisht në Breg të Lumit, ku në oborrin e Kishës së Shën Shtjefnit martir - I mbështjell me flamurin kuq e zi do i priste memoriali me 7 emrat e 7 lumnuemve të Kishës Katolike, dukagjinas.

Qelli i kaltër dhe krejt lugina e Shalës do jehonte nga zëri i kumbonve të kishave të Abatit, Gimajve, Thethit dhe Shën Shtjefnit. E magjishme kjo atmosferë, e cila lajmëronte se pas pak do fillonte festa e Bekuar. Pas mikpritjes nga banoret e famullisë dhe komisionit organizativ, në orën 11.00 filloi Mesha e Shenjtë, e cila u kremtua nga Imzot Angelo Masaffra, kryetar i Konferencës Ipushkvnore të Shqipërisë së bashku me disa meshtarë. Në homelin e tij solli falënderimet ndaj Zotit për shembullin e T'lumnuemve dhe kërkoj ndërmjetësin e tyre për popullin e Dukagjinit dhe krejt Shqipërinë.

Pas Kremtimit të Meshës do bekohej memoriali i 7 të T'lumnuemve. Shtate fëmijë të Dukagjinit mbanin në duar nga një qiri të ndezur simbol i trashëgimisë së Dritës së T'lumnuemve për brezin që ka lindur dhe po rritet në Dukagjin.

Memoriali u zbulua nga Imzot Angelo Masaffra në shoqërinë e Himnit të Flamurit interpretuar nga tenori Lukë Mllugja dhe u bë bekimi i Memorialit nga Imzot Angelo, të cilit ju dhurua një stolë e qëndisur me simboliken e të T'lumnuemve dhuratë kjo nga Gjin Markaj.

Pastaj koordinatori i veprimtarisë Mark Rupa, ftoj Dedë Prendaj për fjalën e rastit, i cili bëri një pasqyrim historisë dhe aktit të T'lumnuemve të 7 bijve të dukagjinit të cilët duke ja dhuruar jetën Krishtit nuk pranuan ti binin mohut as para grykës së pushkës dhe torturave çnjerëzore. Tek dëgjoje jetën dhe veprën e këtyre të T'lumnuemve në shpirt rritej ndjenja e falënderimit për Zotin, që i ka fal, për familjen Dukagjinase, që i rriti dhe i edukoi, për Kishën Shqiptare, që i edukoi dhe i shkolloj. Të T'lumnuemet në çastet e fundit të jetës kërkuan falje për ata që po i vrisnin. Mesazh që plumbi se zhduku e koha e ruajti thesar për brezat.

Pastaj në fjalën e tij Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Benet Beci, cilësoi: “Një monument që flet shumë për të mos harruar, por edhe për të përçarur përpara mesazhin e rëndësishëm të këtyre të T'lumnuemve! Vlerat shpirtërore dhe jeta e të T'lumnuemve na hapin rrugë të reje në zbulimin e zhvillimin e Dukagjinit në të gjitha aspektet. Prandaj së bashku me falënderimet për iniciatorët, bëri thirrje që të punojmë së bashku për të sjellë kësaj Trevë vendin që i takon!”

Ishin mjaftë emocionues dëshmitë e familjarëve të T'lumnuemve (Ndoc Asha, Zef Nika dhe Pjeter Kodra), të cilët shumë përij tyre ishin edhe bashkëvajtjes në burgje dhe internime.

Gjin Markaj, ideatori dhe bashkëfi-

nacuesi i memorialit, krahas mesazhit që përcjell ky memorial, falënderoj Imzot Angelo Masaffren dhe Meshtarët e pranishëm, Pt Gazmend Tinaj famullitarin, i cili edhe pse jo prezent ndihmoi në mbarëvajtjen e punëve, Kryetarin e bashkisë z. Benet Beci dhe grupin organizativë dhe të gjithë banorët, që ndihmuan për sistemimin dhe përgatitjen e kishës dhe ambientit përreth.

E sipas traditës, vendasi beri mbylljen e ceremonisë Zef Sokoli Valadaj, i cili i falënderoj të gjithë të pranishmit dhe Gjin Markaj e Dedë Prendaj, të cilët mundësuan financiarisht realizimin dhe organizimin e kësaj ditë, të cilët në shenje mirënjohje i dhuruan një orë dore Zefit.

Pastaj të gjithë të pranishmit ju drejtuan trupores së Shën Ndout tek Ura e Shalës, për të bekuar, bekimin e dhënë një vitë më parë nga Ati i Shenjtë Papa Françesku, për popullin e Dukagjinit dhe djalin e tij Gjin Markaj që ka kontribuu financiarisht për truporen e Shna Ndout.

Pas bekimit atmosfera festive e kësaj dite dot vijonte në bar-restorant “Zorgj”, në fshatin turistik, qendrën e Alpeve Shqiptare, Theth, me drekën e shtruar për të pranishmit nga Gjin Markaj dhe Dedë Prendaj.

Në përfundim po sjell për lexuesit edhe disa momente nga puna e disa ditëve në Kishën e Shën Shtjefnit nga Altini, nipi Gjinit, i cili kishte ardhur nga Londra dhe ishte i palodhur, duke punuar si kosëtarë, murator, kuzhinier e të tjera. Djali i palodhur dhe gjithmonë entuziast, Mitri dhe Mirja, Marku, Roza dhe Florenci.

Dua ta mbyll kronikën me një falënderim të madh për mjeshtrit Zef Muri, për skalitjen e memorialit, Ndue Stakën me djalin e tij, Franin, të cilët edhe pse shiu i binte pothuajse gjatë gjithë kohës ata qëndisën me gurë bazamentin e memorialit, të cilin e dhuroj Dodë Lucaj.

Falënderojmë të gjitha Mediat që ishin të pranishme dhe pasqyruan veprimtarinë.

Në vazhdimësinë e iniciativave dhe projekteve të shumta të ideuar dhe realizuar gjithmonë me sukses nga Gjin Markaj, Dedë Prendi dhe disa shaljanë më banim në SHBA në si bashkësi dukagjinas, krahas falënderimeve të përzemërta, jemi krenar që Dukagjini ka rritë e po rritë të T'lumnuemve e Martirë për Fe e Atdhe. Bijë e bija që i kanë përcjell rrezet e diellit nga njëra kresht tek tjera, nga njëri shekull tek tjetri. Për fe e Atdhe jemi së bashku gjithmonë. Martirët e Kishës Katolike ndërmjetësoj përpara Krishtit Mbret për Dukagjini që të jetë gjithmonë i bekuar!



ATË ÇIPRIAN NIKA O.F.M.

Atë Çiprian Nika lindi në Shkodër më 17.09.1900. Studioi në Seminarin e Fretërve Minorë të Shkodrës, pastaj në Lankoëitz dhe Grac të Austrisë dhe për Teologjinë në Romë e Peshia të Italisë. U shugurua meshtar në Romë më 25.07.1924. Dha mësim në Seminarin e Fretërve Minorë. Qe Mësues i xhakojve (1929-1932), Mësues i novicëve (1932-1938), Ministër Provincial (1938-1941), Drejtor i Seminarit Françeskan (1941-1944), Guardian i Gjuhadorit prej vitit 1944 derisa vdiq. U arrestua në Shkodër dhe u burgos më 15.11.1946. U dënua me vdekje më 27.12.1947 dhe u pushkatua më 11.03.1945




ATË BERNARDIN PALAJ O.F.M.

Bernardin Palaj lindi në Shkodër më 02.10.1894. Ndoqi të gjitha shkollat e Fretërve Minorë të Shkodrës, kurse liceun e bëri në Salisburg dhe Filozofinë e Teologjinë në Insbruk të Austrisë. U shugurua meshtar më 02.08.1918. Dha gjuhë shqipe dhe latine në Gjinnazin Illyricum të Fretërve Minorë. Punoj në famullitë e Toplanës, të Palçit, të Shalës, të Bushkashit, të Planit dhe të Rubikut. Botoi shumë shkrime në shtypin kishtar të kohës, posaçërisht në “Hyllin e Dritës” e në “Zanin e Shna Ndout”, por edhe në gazetën “Tomori”. Palaj ishte anëtar i Institutit të Studimeve Shqiptare, që më 1940. Ka botuar edhe librat “Prej burgut të jetës”; “Vorreve të flamurit”, “Kuq e zi, “Mite, besime, legjenda” (ribotuar pak vite më parë në Kosovë); “Kanuni i maleve” e të tjera. U arrestua në Rubik, në kuvendin ku ishte Epror, dhe u burgos në Shkodër më 22.10.1946. Vdiq në burgun e Shkodrës, prej torturave, përpara se të dënohej, më 02.12.1946.



ATË GJON SHLLAKU O.F.M.

Atë Gjon Shllaku O.F.M lindi në Shkodër më 27.07.1907. Studimet universitare i bëri në Lovanio të Hollandës dhe në Paris. U shugurua meshtar më 15.03.1931. Dha mësim filozofi, gjuhë frënge, politikë dhe ekonomi në Liceun Illyricum të Fretërve Minorë. Për një periudhë të shkurtër qe, dy herë, Zëvendës-famullitar në Theth dhe, prej datës 14 korrik deri më 27 nëntor 1945, në Nikaj, duke zëvendësuar Atë Dioniz Makajn, njëri prej fretërve të parë të arrestuar. U arrestua në Shkodër më 23.01.1946, ndërsa jepte mësim në klasë. U dënua me vdekje më 22.02.1946. U pushkatua në Shkodër, në orën 5 të mëngjesit, më 04.03.1946, dhe u la aty, së bashku me Atë Danjel Dajarin S.I., Atë Giovanni Fausti-n S.I., Seminaristin Mark Çuni, të rinjtë Qerim Sadiku, Gjelo Lulashi e të tjerë.



ATË GASPËR SUMA O.F.M.

Atë Gaspër Suma lindi në Shkodër më 22.03.1897. Studioi në Shkodër dhe pastaj në Vjenë, Grac e Lankoëitz të Austrisë. Teologji studioi në Shkodër dhe Gjenovë. U shugurua meshtar në Gjenovë më 24.07.1921. Dha mësim në Seminarin e Fretërve Minorë të Shkodrës. Qe Famullitar në Përshkash (1923-1924), Nikaj (1927-1931), Toplanë (1932-1942), Theth (1942-1943). Prej kuvendit të Brigjeve ka shërbeu në Hot e Rapshë (1943-1946) dhe në Gomsiqe (1946-1947). Qe Guardian i Gjuhadorit dhe Kapelan i Motrave Stigmatine të Shkodrës. U arrestua në Gomsiqe dhe u burgos në Shkodër më 24.05.1948 dhe më 22.08.1949 u dënua me tre vjet burg. Vdiq prej kancerit në Burgun e Madh të Shkodrës më 16.04.1950. Trupi i tij pushon në kishën e Fretërve Minorë të Shkodrës.



DOM DEDË PLANI

Dom Dedë Plani lindi në Shkodër më 21.01.1891. Studioi Filozofi në Seminarin Papnor të Shkodrës dhe Teologji në Insbruk të Austrisë në Kolegjin Canisianum të Jezuitëve. U shugurua meshtar në Primiz të Austrisë më 03.08.1919. Prej marsit të vitit 1920 qe famullitar i Gimnazjeve të Shalës, pastaj i Pogut, i Prekalit, i Kirit, i Shirokës dhe, prej vitit 1947, i Rrencit të Gurit të Zi. U arrestua dy herë në vitin 1945 në Shirokë dhe u lirua disa muaj më pas. U arrestua përfundimisht në Rrenc të Gurit të Zi në shtator-tetor të vitit 1947 dhe u burgos në Shkodër. Vdiq gjatë torturave, përpara se të dilte në gjyq, më 30.04.1948.



GJELOSH LULASHI, LAIK

Gjelosh Lulashi lindi në Ndreaj të Shoshit të Dukagjinit më 02.09.1925. I Dioqezës së Pultit, tani Shkodër-Pult. Qysh në moshën 7 vjeçare ndoqi shkollat në Shkodër te Fretërit Minorë dhe pastaj në Seminarin Papnor Shqiptar. Ushtarak, Sekretar i Spitalit Ushtarak të Shkodrës. U arrestua dhe u burgos në Shkodër më 03.12.1945. U dënua me vdekje më 22.02.1946. U pushkatua në Shkodër, në orën 5 të mëngjesit, më 04.03.1946, dhe u la aty, së bashku me Atë Danjel Dajanin S.I., Atë Giovanni Fausti-n S.I., Atë Gjon Shllakun O.F.M., Seminaristin Mark Çuni, të riun Qerim Sadiku e të tjerë.

**E përgatiti Roza Pjetri**



DOM LAZËR SHANTOJA

Dom Lazër Shantoja lindi në Shkodër më 02.09.1892. U shugurua meshtar në Shkodër më 29.05.1915. Kapelan ushtarak, Zëvendës-famullitar në Shkodër, Famullitar në Pulaj (Velipojë) dhe pastaj në Sheldi. Kancelar dhe Noter arqipeshkvnor. Sekretar i Arqipeshkvit të Shkodrës. Ka qenë prift dioqezan, publicist, përkthyes i Gëtes, Shilerit dhe Leopardit, poet lirik, satirist dhe esperantisti i parë shqiptar. Si i arratisur, nën regjimin e Ahmet Zogut, qe në Beograd dhe pastaj në Zvicër si Kapelan në Schëandegg, Zëvendës-famullitar në Biel dhe famullitar në La Motte. Kur u kthye në Shqipëri, në tetor të vitit 1939, veprimtarinë e vet baritore e zhvilloi duke banuar kryesisht në Tiranë. U arrestua në Sheldi në fund të dhjetorit të vitit 1944 dhe u burgos në Shkodër. U dënua me vdekje në Shkodër më 30.01.1945. Gjykata e Lartë e Tiranës konfirmoi dënimin e tij me vdekje më 02.02.1945. U pushkatua në Tiranë më 05.03.1945.





# UDHËTIM NËPËR ALPET SHQIPTARE

Porta alpine e Vuklit një destinacion turistik që kërkon rrugë Kohët e fundit turizmi malor është kthyer në një atraksion shumë të rëndësishëm kulturor, i cili gjithnjë e më shumë po nxit turistët vendas dhe të huaj të ndërmarrin ekspedita, për të njohur nga afër natyrën e gjallë të Alpeve Shqiptare. Megjithëse një terren i thyer e me shumë të pa njohura, të apasionuarit pas alpinizmit nuk i pengon të ngjiten në lartësitë e kreshtave e të majave të thepisura, për të shijuar me sy të lirë pamjet mahnitëse që të ofron nëna natyrë në këndin 360°, që ta mundësojnë pikat më të larta të tyre. Nisur nga eksperiencat mahnitëse të këtyre alpinistëve, si dhe jehona që morën Alpet Shqiptare të shpallura së fundmi "Park Kombëtar" apo "Zonë e Mbrojtur", Kelmendi dhe Thethi u kthyen në destinacione tejet të rëndësishme turistike, aq sa fluksi i vizitorëve të njohë rritje drastike, në krahasim me një apo dy dekada më parë. Një ndihmë të madhe ka dhënë edhe vëmendja e qeverisë, e cila ndërtoi rrugë, zhvilloi fshatra turistik dhe hapi pika të reja kufitare, në Kelmend të Malësisë së Madhe, duke u krijuar kështu mundësi udhëtarëve dhe vizitorëve të depërtojnë me lehtësi, nëpër këtë korridor të pasur natyror. E gjithë kjo përfaqësi dhe vëmendje ndaj Alpeve, ka bërë që edhe vetë banorët të ndërgjegjësohen e të kuptojnë se turizmi malor po ndikon në zhvillimin social dhe ekonomik të tyre, duke u hapur fronte pune dhe duke dhënë mundësi për ta shfrytëzuar në maksimum, për rritjen e mirëqenies së tyre. Ndërtimi apo kthimi i banesave në bujtina, përshtatja dhe pasurimi me objekte muzeale, si dhe promovimi i gastronomisë tradicionale, ka bërë që përgjatë gjithë sezonit veror, ky territor alpin e këto bjeshkë përrallore, të tejmbushur me pushues dhe vizitor. Ky fenomen dhe ky zhvillim infrastrukturor, në vitet e fundit e ka zgjeruar hartën e destinacioneve turistike alpine, por nga ana tjetër, ka penalizuar një pjesë mjaft të rëndësishme, në zemër të Alpeve Shqiptare. Fshatrat e Kozhnjes, Vuklit dhe Nikçit, tre destinacione të një rëndësie të veçantë, jo vetëm si mjedis natyror, por edhe si vendbanime të përmendura që në antikitet, me një numër të madh banesash, kullash alpine apo shtëpish të ngurta, për mungesë të infrastrukturës rrugore, janë kthyer në destinacione të pa mundura për pushuesit, vizitorët apo turistët, të cilët në mungesë të saj, mundohen të përdorin mjete rrethore për ti vizituar këto resurse kulturore e natyrore, por kurrë për t'i shijuar, pasi për të depërtuar nëpër këto porta alpine veç lodhjes, rrishtit i dëmeve është kurdoherë prezent. Ky makth ka bërë që vetë banorët e këtyre fshatrave dita-ditës ta braktisin këtë vend të thyer malor, pasi në mungesë të kësaj rruge të asfaltuar e të sigurte dhe lëvizjes së lirë të banorëve, mundësitë e punësimit janë më pak se minimale, çka e bën të pa mundur jetesën e tyre. Me pak tokë bujqësore dhe me blegtori akoma më pak të zhvilluar, të gjitha këto, të kushtëzuara nga dimrat e gjatë e të acartë, të krahasuara me ritmet e zhvillimit të jetës bashkëkohore, e

kanë shndërruar këtë zonë në një vend mbijetese, ashtu siç thonë vetë malësorët "me dalë në Shëngjergj me shpirt ndër dhamë". - Ku s'ka rrugë, nuk ka as jetë. Në mungesë të rrugës, në pjesën më të

të përmalluar nga ato bregore, ku etërit e tyre prehen në varret shekullore. Shumë malësor nga Vukli, Kozhnja, Nikçi apo edhe kelmendas të migruar e të emigruar nëpër botë, nuk reshtin së shprehuri ind-

saj turizmi malor, turizmi kulturor, si dhe turizmi dimëror, do merrnin zhvillim të vrullshëm, duke rigjallëruar edhe jetën e kësaj krahine të rëndësishme të Kelmendit. Kushtet klimaterike, resurset natyrore



madhe të kohës, në këto fshatra mungon shërbimi shëndetësor, mungon energjia elektrike, mungon shërbimi i zjarrfikëses, mungon shkollimi me kushte bashkëkohore, mungon tregtia e lirë dhe shërbimi ambulant e shumë shërbime të tjera bazike, sikurse komunikimi valor e kabllor, me telefon dhe internet. E në mungesë të të gjitha këtyre nevojave biologjike, pak kush e merr guximin t'i vizitojë, të pushojë e aq më pak të jetojë në këto zona alpine. Ky është edhe shkaku pse banorët e këtyre fshatrave dita-ditës po e braktisin përgjithmonë vendin, atë mrekulli natyrore, ato fusha, kulla e kroje. Po largohen

injatën e tyre për gjendjen dhe fatin, me të cilin po përballet vendlindja e tyre sot. Të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë ndaj amanetit të të parëve dhe atyre trojeve të shenjta që etërit u lanë në trashëgim, të mbrojtura me gjakun dhe jetët e tyre, këta malësorë kelmendas, bij të Malësisë, i gjen sot të kuvendojnë bashkë për t'i dalë në pritë kësaj masakre të shpopullimit masiv. Gjaku nuk bahet ujë, thonë malësorët, ndaj edhe pse të shpërndarë nëpër botë, sa herë bie kushtimi, i thërret vendlindja, ata bashkohen dhe bëhen sërish një familje, për t'i dhënë një dorë mbështetje e besimi njëri - tjetrit. Falë këtij uniteti vullnetmirë, ata mblodhën fonde e ndërtuan banesa, ndërtuan qendrën funerale, mbështeten me ndihma familjet në nevojë gjatë pandemisë, ndërtuan rrugë e ura, varreza apo mbështeten financiarisht aktivitetet kulturore, në mënyrë që të gjallëronin e të bashkonin vllazninë në tërveza gëzimi. Sot këta malësor i gjen më të bashkuar se kurrë, për një qëllim të lartë. Të ndërtojnë me çdo kusht rrugën e Vuklit, qendrën që lidh këto fshatra, ndaj për këtë qëllim shpesh herë u janë drejtuar edhe institucioneve shtetërore, në mënyrë që projekti për ndërtimin e kësaj rruge, të vihet në zbatim para se të jetë tepër vonë, për fatin e kësaj zone. Benefitet që ofron ndërtimi i kësaj rruge janë më të shumta se të çdo rruge tjetër rurale në Malësi. Me ndërtimin e

dhe kulturore, të shtrira në një territor të gjerë me bjeshkë e me verri, panorama e së cilës të ofron pamje përrallore, do ta kthenin këtë zonë në një destinacion me za' dhe atraksion tejet të zhvilluar turistik. Veç kësaj, kjo zonë rezultojnë të jetë e përfshirë edhe në "Brezin e Gjelbërt", si zonë e veçantë dhe e pasur për florën dhe faunën autentike të saj, të mbrojtur nga izolimi ndërkuftar. Gjithashtu falë këtij izolimi, kjo zonë është e përfshirë në "Brezin e Gjelbërt" edhe për faktin se ka ruajtur me fanatizëm ritet, zakonet dhe trashëgiminë e pastër kulturore, gjë që ngjall akoma më shumë interes për turistët. Ardha e turisteve vë në lëvizje gjithë mekanizmin e zhvillimit të zonës. Hapjen e bujtinave, ndërtimi i një termocentrali për sigurimin e energjisë elektrike, zhvillimin e bujqësisë, zhvillimin e blegtorisë, çeljen e baxhave dhe punishteve artizanale, të cilat për hire të vërtetës rezultojnë të jenë disa në këtë zonë. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, të gjitha këto benefite do t'u impononte malësorëve të Kozhnjes, Vuklit dhe Nikçit, rikthimin e përhershëm në vendlindjen e tyre. Kjo pasqyrë dhe kjo analizë e situatës aktuale në Kelmend, do mjaftonte që pushteti vendor, apo qeveria shqiptare, në bashkëpunim me fondin e zhvillimit rural, të vihen në lëvizje për zbatimin e këtij projekti, në mënyrë imediate, se vetëm kështu mund të ndalet kjo valë shpopullimi e ti hapet rrugë këtij zhvillimi, sepse Alpet Shqiptare janë dhe do të mbeten përgjithmonë pasuri kombëtare.

Rita Shkurta, shtator 2023



# Festivali i lahutarëve

Me datën 24 shtator 2023 ditën e Diele, në Studion muzikore etnografike “Besa - Shosh”, me qendër

në Bardhaj Shkodër u mbajt festivali mbarëkombëtar i lahutarëve shqiptar, dita e tret e edicionit të

peste, me titull ‘Lahuta - Okarina dhe Polifonia Shqiptare’.

Qëllimi i kësaj veprimtarie është njohja ndërkombehtarë e këtyre vlerave dhe dërgimi tyre në UNESCO

si vlera Botërore.

Dita e pare ose ndryshe hapja e këtij festivali është mbajt me datën 13 gusht të këtij viti, në Mitrovicën e Veriut të Kosovës, ku ishim edhe ne lahutarët nga Shkodra të ftuar në këtë festival.

Por, manifestimi kombëtar- “Logu i Bjeshkës” në Kelmend na privoj nga pjesëmarrja për arsye se te dy

këto veprimtari mbaheshin në një datë dhe lahutarët nga Shkodra ishin të ftuar në “Logun e

Bjeshkës- 2023” dhe nuk morën pjesë.

Ndërsa dita e dytë e këtij festivali u mbajt në Hoten të Plavës, me datë 23 shtator 2023, në të cilën ishin të ftuar dhe lahutarët nga Shkodra, Lezha dhe Malësia e Madhe: Lulash Pllumi, Lumturi Nonaj, Emanuel Suka dhe Gjon Kosteri.

Në kete kronike do të shkruaj për ditën e tretë të edicionit peste, që u mbajt në studion “Besa- Shosh”.

Së pari, ftesës së organizatorit të këtij festivali, z. Sokol Plakolli për të mbajt një festival me lahutarë në

Shkodër dhe pikërisht në Studion “Besa- Shosh” dhe kryetari i kësaj shoqërie kulturore e artistike, z. Ndoc Fusha, na u përgjigj shumë bujarisht dhe na krijoj të gjitha mundësit skenike për një festival të përmasave teatrore, me mikpritjen shqiptare mirë se ju ka pru Zoti- “Shpija e zotit dhe e mikut!”

Bukë e kripë e zemër, pa asnjë mbështetje nga askush, por pasioni i tij për artin e kulturën na mundësoj realizimin e këtij festivali me mjaft cilësi.

Ne, ishim lahutar nga Shqipëria dhe Kosova, munguan lahutarët nga Mali i Zi për një incident gjate udhëtimit, Ishe prezentë në regjistrime gazetarja e njohur i TV 1-Channel i emisionit “Arome Shkodre”, znj. Kozeta Bruçi.

Moderatori i këtij festivali ishte organizuesi i tij, z. Sokol Plakolli, i cili prezantoi lahutarët me radhë.

Festivalin e hapi lahutari më i ri, Emanuel Suka nga Thethi dhe pastaj kënduan me radhe Leonid Shllaku nga Klina; Lulash Pllumi nga Lezha; Isa Elez Muriqi nga Peja; Gjon Kosteri nga Shoshi; Hysen Kurti nga Rugova dhe Lumturi-je Nonaj, e vetmja femër lahutarë, në festival e është quajtur “Zana Shqiptare”.

Në fund programin e këtij festivali e mbylli i zoti i shtëpisë, z Ndoc Fusha, me një këngë me Sharki, m titull “Të Bijtë e Shqipes”

Realizimi i këtij festivali ishte prefekt!

E veçanta, në këtë festival ishte se, të gjithë lahutarët interpretuan direkt, në mënyrën e vet, secili i lirshëm, në dialektin e vet, me veshjen tradicionale kom-



Lumturije Nonaj



Leonid Shllaku



Sokol Plakolli, organizator



Isa Murqi



Hysen Kurti, lahutari më i vjetër



Emanuel Suka, Gjon Kosteri e Lulash Pllumbi



bëtare nga treva që i përkiste.

E veçanta tjetër ishte, se u hodh ideja nga organizatori dhe na u kërkuar ne si shoqëri kulturore të

organizonim një klasë për lahutar në Sheperi, me qendër në Shkodër, dege e shkollës së lahutarëve, me

qendër në Prishtinë; ndërsa në Pre-

sheve, në Plave dhe në Mitrovicën e Veriut janë krijuar klasa të tilla për mësimin e lahutës nga moshat e reja dhe në veçanti rendësi t'i kushtohet mësimin nga ana e vajzave.

Ne e mirëpritim këtë ide dhe do mundohemi ta bëjmë realitet.

Në fund të këtij shkrimi dua të falën-

Së pesti, jo për nga niveli i rëndësisë, se pa ju nuk mund të organizohej ky festival, ju lahutar, që në mënyrë shume fisnike dhe bujare morët pjese në këtë festivali dhe i dhatë fryme e jete lahutës Shqiptare!

Së gjashti, faleminderit të gjithë ju miq dhe adhurues të lahutës dhe në përgjithësi të artit folklorik!

Së shtati, faleminderit gazeta “Dukagjini”, që na promovon, na motivon dhe na mbështet çdo here pinen tone në fushën e folklorit!

**Gjon Kosteri,**  
studio “Besa Shosh”,

Shkodër, me 24 shtator 2023

# NIS RRUGËTIMIN E SAJ RADIO “ESENCË”

Një nisëm e veçantë dhe një risi e re e “Mjeshtrit të Madh”, humoristit Shkodran, Sandër Ruçi.



Ramazan Çeka

Risia nis hapësirën e re të komunikimit me publikun, në ambientet e shtëpisë së Sandrit, si një Oaz artistik që i shtohet Shkodër Loces tonë, qytetit të tij të zemrës.

Në këtë inaugurim të studios së re, Sandri bëri bashkë emra të mëdhenj të humorit, këngëtarë, poetë, simpatizantë, artdashës, shumë miq dhe bashkëpunëtor të artit dhe kulturës, por dhe mediat që vlerësuan dhe nderuan këtë nisëm të veçantë të aktorit të njohur shkodran, humoristit, Sander Ruçi, këtij mjeshtri të rrallë, me një performancë gjithnjë e më të ndritur edhe pse jeton prej disa vitesh në Jacksonville, Florida të SHBA, asnjëherë nuk i ka shkëputur lidhjet me qytetin e tij të lindjes. Duke u takuar me të gjitha kategoritë e njerëzve, ai u shpreh se, këto momente magjike që po kalon mes tyre, po më zgjasin jetën, ndaj i falënderoi me shumë përvullje. Këtë respekt Sandri ia ktheu me kënaqësi në këtë natë të inaugurimit të RADIO “ESENCË”.

Festa me miq dhe me shokë vazhdoi si të ishte një spektakël.

Ai u rikthye në Shkodër jo vetëm për ta vizituar e për t’u çmallur me të afërmit, me shoqërinë e me kolegët, por edhe për të treguar se talenti i tij nuk ka shteruar,



përkundrazhi me një buqetë skeçesh, parodish, monologësh humoristike dhe satirike u ngjit disa herë në skenën e Teatrit “Migjeni”, me recitalet e tij, duke sjellë një performancë që edhe nga ana regjisoriale kishte risi.

Është vërtetë bukur kur artistët punojnë për kontributin e punën e tyre. Ky është një tregues i vlerësimit të një karriere të gjatë, jo vetëm nga spektatorët si vlerësimi më i mirë, por edhe i institucioneve.

Në këtë nismë, krahas becgraundit të shumë llojshëm artistik, Sandri jo rastësisht është edhe para mikrofonit në Studio, pasi ai ka një eksperiencë rreth katër vjeçare në Radion lokale, siç është ajo e Radio Shkodrës, ku emisioni famëmadh humoristik “100 fjalë për një parë”, që Sandri e ka udhëhequr me mjaft kompetencë, ka mbete si një gurë i çmuar në arshivën e Radio Shkodrës.

Por Sandri nuk ndalet në rrugën e tij brilante. “Esencë” është radio më e re në Shqipëri që i shtohet Shkodrës dhe që Sander Ruçi të gjitha pajisjet elektronike i ka sjellë nga Amerika dhe ka vendosur të vijë ndryshe këtë herë tek publiku, me aromën puro shkodrane.

Si president i kësaj Radio, Sandri e ka ideuar dhe realizuar mbi bazën e përvijës shumëvjeçare që ka fituar në SHBA, duke qenë zyrtarisht shtetas amerikan, kjo radio do jetë e hapur për larmi të pa fund vlerash, ku humori është në krye të vendit, me përjashtim të politikës që do të mbyllet dera.

Atmosferën e kësaj mbrëmje, Shkodra e përjetoj me shumë emocion, kur Sander Ruçi deklaroi kthimin e tij në Shkodër, i cili kishte kohë që përgatitej për t’i dhuruar qytetit të vet, artdashësve të mrekullueshëm shkodranë këtë Radio, e para e këtij lloji dhe mund të themi pa ndrojtje që ishte një arritje në radhë të parë personale, pasi ai është autori i shumë materialeve letrare, regjisor dhe aktor brilant që natyrisht inaugurimi i kësaj Radio, do bëjë të mundur që Sandri përmes gërshetimit edhe disa projekteve përmes kësaj Radio do të pasqyrojë fragmente dhe kuriozitete nga jeta e njerëzve të ndryshëm që janë kushtuar artit dhe skenës.

Sandri si krijues që me karakterin e tij, zhdërvjelltësinë, sigurinë autoriale e mbi të gjitha talentin e tij ka një marrëdhënie komunikimi të habitshme dhe të pakrahueshme me një tjetër, me publikun. Ai i bën për vete, i elektrizon dhe si të thuash, entuziazmon, e çon në këmbë edhe spektatorin më indiferent. Salla për aq orë e minuta që zgjat shfaqja, shpërthen me duartrokitje dhe ovacione të shoqëruara me të qeshura të çiltra, ku mund të shprehemi shkodrançe “Kam qesh me lot”.

Me talentin e tij të fuqishëm si aktor, regjisor dhe menaxher ai përfaqësohet denjësisht para publikut artdashës Shkodran, duke dëshmuar e rrezatuar fuqishëm mesazhin frymëzues për gjithë bashkatdhetarët e vet dhe për gjithë miqtë e dashamirësit tanë se sa talente të shkëlqyer ka nxjerrë dhe vijon të nxjerrë nga gjiri i vet, të formojë dhe edukojë



kombi i talentuar shqiptar.

Me këtë rast edhe ne i urojmë “Mjeshtrit të Madh” Sandër Ruçi suksese për këtë risi të veçantë, dhuratën që i bëri Shkodrës, RADIO «ESENCË», si një produkt i karrierës së tij artistike, duke e falënderuar për punën e palodhur dhe

përkushtimin e madh që tregon herë pas here për publikun e mrekullueshëm shkodran, duke dhuruar edhe humor brilant e bashkëkohor me nivel të lartë artistik.

# Bashkia e Maceratës promovuar bashkëjetesën e bashkësisë Shqiptar në Macerata

**OH VITA! Bashkia e Maceratës në bashkëpunim me shoqatën kulturore Iliria, me 5 mars 2023 organizuan veprimtarinë “OH VITA”, një veprimtari për të promovuar bashkëjetesën e bashkësisë Shqiptar në Macerata, i cili daton qysh në vitin 1391. Një falënderim special shkon për profesorin Mark Palnikaj, i ftuar special i kësaj veprimtarie, i cili udhëtoi enkas nga Tirana!**

## Fjala e Profesor Dr. Mark Palnikaj, në këtë veprimtari

I nderuar kryetari i Bashkisë së qytetit të Maçeratës, z. Sandro Parkaroli,

Të nderuar studiues dhe profesorë pjesëmarrës të këtij takimi,

Të nderuar organizatorë të kësaj feste madhështore,

Të nderuar bashkatdhetarë të mi,

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë që ndodhem sot midis jush dhe t'ju sjell përshëndetjet dhe urimet më të mira në këtë takim të rëndësishëm të organizuar nga Bashkia e Maçeratës me rastin e festës të lagjes “Le Casette” dhe kushtuar “Jetës” në të gjitha fushat që ajo përfshin, si artin, sportin, kulturën, historinë, pa dallim moshe, kombësie apo bindje politike.

Në këtë rrjedhë jemi ftuar për të folur për lidhjet e pashkëputura të popullit shqiptar gjatë më shumë se 500 viteve me popullin autokton italian të kësaj treve dhe në veçanti për praninë shqiptare në këtë qytet qysh prej shekullit XV.

Në popullin e Italisë populli shqiptar ka gjetur derën e miqësisë dhe të bujarisë të hapur gjatë gjithë shekujve duke jetuar dhe bashkëpunuar si dy vëllezër të mirë e të bekuar nga Zoti.

Në ditët e tij më të vështira, i ndjekur nga tartarët vandalë të Perandorisë Osmane, nën një terror të paparë dhe të padëgjueshëm më parë, i larguar nga trojet e veta shekullore, një pjesë e popullit shqiptar gjeti strehë, mikpritje dhe përkrahje në vatrën dhe vendet e popullit të lashtë të Italisë.

Ai i ndjekur nga pushtuesit barbarë dhe i përcjellë nga probleme të tjera, gjeti tek fqinjët e vet natyror italian derën e mikpritjes dhe të miqësisë në mënyrë të pashkëputur.

Pikërisht ky takim i ngrohtë kulturor tregon qartazi e më së miri vazhdimësinë e këtyre marrëdhënieve paqësore të ndërsjella.

Gjatë më shumë se 500 vitesh, populli italian lejoi që miqtë e ardhur nga përtej detit të jetonin dhe të punonin së bashku, të ruanin gjuhën dhe kulturën e tyre, të zhvillonin gjuhën e shkruar dhe artet e tjera pa xhelozë dhe pa kufizim.

Nëse në vendin e tyre të origjinës ushtrimi i lirë i fesë dhe të shkruarit e gjuhës amtare ishte i ndaluar nga pushtuesi osman, në Itali shqiptarët ushtronin të lirë fenë e të parëve të tyre në gjuhën që ata donin, dhe hapën shkolla të niveleve më të larta për kultivimin e gjuhës dhe të kulturës së tyre.

Nën pushtimin osman gjuha shqipe u lejua të shkruhej vetëm në vitin 1908, mbas pesë shekujve që ishte e ndaluar. Një ndihmë vendimtare dhanë në këtë drejtim arbëreshët e Italisë dhe misionarët

franceskanë dhe jezuitë që shërbyen me vetëmohim në vendin tonë për shekuj me radhë.

Janë të jashtëzakonshme punimet shkencore për gjuhën, kulturë, historinë dhe fushat e tjera të shkencës për Shqipërinë të botuara nga studiuesit italianë.

Në Itali u botuan gramatikat e para të gjuhës shqipe, pesë fjalorë të mëdhenj për gjuhën shqipe nga viti 1635 deri në vitin 1876. Në vitet tridhjetë të shekullit XVII u hapën dy kolegje në Loreto dhe në Fermo për studentët nga Iliriku me drejtim fetar dhe shkencor, ku morën dije dhe kulturë figura kryesore të historisë së Shqipërisë, të cilët lanë gjurmë të pamohueshme në kulturën dhe historiografinë shqiptare. Në vitin 1711 është hapur katedra e gjuhës

tregon se para ardhësit tanë, domethënë arbëreshët, erdhën edhe këtu, si në shumë qytete të tjera të Rajonit Marche, ashtu si na tregoi në fjalën e tij Prof. Moroni. Unë pata fatin disa muaj më parë që ta shikoja konkretisht këtë prani në qytezën fqinje të Fermos.

Fondet historike rrëfejnë se ata u strehuan në qytezën e Maçeratës duke filluar nga fundi i shekullit XIV dhe më tej, ndoshta edhe me një farë vështirësie në fillim, dhe më vonë u integruan më së miri, dhanë kontributin e tyre në zgjerimin si dhe në mbrojtjen e qytetit, fituan prona dhe ndërtuan kisha dhe lagje si ajo e “Le Casette”, por detajet e kësaj pranije ka dëshmuar Prof. Ruffini, i cili e ka studiuar me thellësi dhe e njeh më së miri këtë

jehërë nuk morën karakter përballjesh. Ky është rezultat i mençurisë, por edhe i tolerancës që i ka karakterizuar në vazhdimësi banorët e dy popujve që banojnë këtu prej më shumë se 550 vite në fqinjësi dhe bashkëpunim. Zakonisht konfliktet që kanë karakter nacional, fisnor dhe fetar marrin përmasa të mëdha dhe kanë pasoja tragjike për të dyja palët. Në trevat e Gadishullit Ballkanik ku përfshihet edhe kombi shqiptar, për fat të keq, konflikte të tilla ka pasur shumë dhe me pasoja të rënda. Në Itali, midis shqiptarëve dhe italianëve, s'kam të dhëna që të kenë ndodhur kurrë diçka e tillë.

Mbas shembjes së sistemit komunist në Shqipëri në vitin 1991 pati një dyndje të shqiptarëve në numër të madh drejt shtetit Italisë. Shteti dhe populli i saj demokratik edhe këtë herë i priti miqtë nga Shqipëria me krahë hapur, pa asnjë lloj racizmi ose shpërfilljeje, duke u bërë vend në qendra të organizuara nga shteti, por edhe në qindra raste, familjet italiane i pritën këta fatkëqij pranë familjeve të tyre, duke u ofruar ndihmë dhe shpresë se do të kishin një të ardhme më të mirë.

Në vitin 1993, kam pasur rastin të qëndrojmë në Itali në mënyrë të ligjshme dhe të punoj sipas rregullave dhe ligjeve një vit në Firencë në provincën e Toskanës. Në atë kohë kisha nevojë të madhe për ndihmë dhe mbështetje dhe kam gjetur në familjet e thjeshta në qytetin e Pratos dhe të Firences një pritje të ngrohtë që nuk mund ta harroj për gjithë jetën. Aty jam miqësuar me persona dhe familje të ndryshme dhe kjo miqësi vazhdon edhe sot e kësaj dite mbas tridhjetë viteve.

Më mbushen sytë me lot kur i kujtoj vështirësitë që pata në fillim dhe dorën e ngrohtë që më ofruan

persona të ndryshëm në këto qytete.

Sot është data 5 shtator dhe unë jam midis jush i ftuar si mik i juaji. Për mua kjo ka një domethënie të veçantë sepse unë jam lindur pikërisht me datën 5 shtator 1954, plot 69 vjet më parë dhe jam i lumtur që përvjetorin e datëlindjes time po e kremtoj midis vëllezërve të mi nga Shqipëria dhe me sivëllezërit të mi nga Italia.

Në vitin 2023 kam ardhur në Itali katër herë për qëllime pune. Dy herë kam ardhur si mik, së pari më datën 2 prill 2023, i ftuar nga Bashkia e qytetit të Fermos në një ceremoni promovimi të librit tim me dokumente nga biblioteka e këtij qyteti dhe sot i ftuar në këtë bashkëbisedim vëllezëror në qytetin e Maçeratës, me një histori dhe kulturë të lashtë, të njohur jo vetëm në Itali por në shumë vende të botës.



shqipe në Monastirin San Pietro di Montorio në Romë, që i ka ndihmuar shumë zgjimit të identitetit kombëtar të popullit shqiptar.

I përmenda vetëm këto fakte me rëndësi madhore për gjuhën dhe kulturën në Shqipëri, të mjaftueshme që ta bëjnë krenar çdo italian për ndihmën dhe kontributin e dhënë dhe çdo shqiptar të jetë mirënjohës për këto kontribute.

Edhe sot e kësaj dite në shkollat dhe Universitetet e Italisë e vazhdojnë shkollën qindra shqiptarë.

Në qytezën e Maçeratës historia na

histori.


Mirëpo, historia përsëritet, dhe ky fenomen u përsërit edhe në vitet '90, si rrjedhojë e emigrimit masiv që ndodhi në ato vite.

Historia e marrëdhënieve midis popullit mikpritës italian dhe banorëve të ardhur nga vendet e Arbërisë matanë detit Adriatik, nuk njihet përballje ose mosmarrëveshje midis tyre, por vetëm harmoni, ndihma dhe nderim pa fund për njëri - tjetrin. Edhe nëse ka pasur ndonjë rast të grindjeve midis personash nga kombe të ndryshme, grindjet asnjëherë

# AT' BENARDIN PALAJ - JUP KAZAZI BERI MARRËZI!

**Dje u përkujtua si pas ritualit tridhjetë vjeçar Kryengritja e Postribës, madje për herë të parë edhe fituesi i elektoral i se majtës vendosi një kurore që më pas e dëbuan nga memoriali.**

At' Benardin Palaj një nga mendjet më të ndritura e elitës shqiptare mes dy luftërave botërore, bleta e visareve kombëtare, Martiri i Kishës, dhe nxënës mbetës në politikë fillo italin i deklaruar. Në muajin gusht 1946 se bashku me At Rrok Gurashin pati një takim në Kishën e Rubikut ku kërkohet kordinimi i veprimeve për fillimin e një Kryengritje që do shpërthente në Shkodër. "Puna është si ta fillojmë këtu brenda pastaj çdo gjë do të shkojë në favorin tonë" (AMB.F.7.889. FQ 285). Pra, priste dhe besonte tek një ndërhyrje anglo-amerikane, gjë që nuk ndodhi as një herë. Me 20 shtator 1946 pas një takimi të fshehtë në pyllin e Rubikut me Gjon Mark Gjonin, At Benardini mëson me hidhërim disfatën e Kryengritjes së Postribës, për të cilën ka shkruar: "Ne dinim shumë mirë kush ishin komunistët dhe forcën që kishin, prandaj ne me forcat tona nuk mund të bënim gjë. Ky rast humbi e nuk kthehet me për jetë... Kjo ishte një marrëzi e Jup Kazazit për të fituar lavdi personale, pasi ishte planifikuar që kryengritja të fillonte në mënyrë të kombinuar". Kjo Kryengritje Palaj e fundosi përfundimisht në pusin e vdekjes, por shikojeni sa realist që është në vlerësimin e saj. Panergjizmat dhe sofizmat politik nga njerëz që nuk i lidhë as gjë me këtë ngjarje jo vetëm nuk i shërbejnë vlerësimin, por përkundrazi e zbehen deri në indiferetizëm. Ngjarje të tilla përkujtohen, vlerësohen, mbahet qëndrim dhe nuk duhet të kthehen në objekt urrejtje armiqësie mes brezave që nuk i lidhje as gjë as me "heroizmat" as "herezitë" e të parëve të tyre. Logjikoni me gjakftohtësi dhe bëni këto pyetje vetes:



Kush e filloi kryengritje komunistet apo antikomunistet?! Kryengritja filloi me pushkë apo me karramele! Në se fillon "loja" me pushkë njëra palë e fiton me gjak. Fituesi dhe humbësi dihen dhe te dy palët përdorën të njëjtin mjet.

Kush ishin komunistët djalli i kuq po i fusim te gjithë në një thes?! Po antikomunistet kush ishin binjakët e tyre fashist të deklaruar si Gjon Mark Gjoni e Jup Kazazi, që manipuluan dhe luajtën me ndjenjat e njerëzve të ndershëm, që lidheshin pas fjalës pa ditë çfarë është politika.

Pse anglo amerikanët nuk luajtën fare vendit?!-Aleatet antifashist nuk mund të bashkëpunoni me ithtarë të mbetur pa çadra të fashizmit. Komunistet nuk i donin, por kishin qenë bashkë në aleancën e madhe të fitimtareve. Kryengritja siç thatë Palaj nuk duhej të fillonte kuturu

ndaj dhe pati pasoja shumë të rënda për të mundurit, që paguan me gjakun e tyre aventurën e prijësve të vet.

E djathta shqiptare ka përdorur vazhdimisht këtë ngjarje si trofe historike për interesat e veta, duke "qarë" mbi dhimbjen e të vrarëve, ndërkohë harron qëllimisht dhe kurrë nuk e foli një fjalë të vetme për Kryengritjen anti Zogiste të Dukagjinit të nëntorit 1926, e cila nga bilanci i viktimave është fatale për kohën 15 të vrarë në litarë 22 të dënuar me vdekje në mungese 750 arrestuar nga cilët 220 me bugime të ndryshme. Operacioni spastrimit, u shoqërua djegje plaçkitje dhe dhunimet e bandave mercenare çuan në arratisje masive në Mal të Zi dhe Shkoder. Kjo është panorama e atij Nëntori gjaku (Revolucioni i ri i Shkodrës), i cili nuk duhej të kishte filluar kurrë. Te dyja

këto ngjarje ishin vetëvrasje politike si për Postribën dhe për Dukagjini, të cilat nuk bënë tjetër veç se çuan në konsolidimin e pushtet të dorës se hekurt të Zogut dhe Hoxhes.

Deri kur do trembemi nga të vërtetat, se jemi të gjithë mëkatarë para historisë

Ngjarje të tilla dramatike kanë përjetuar shumica e shteteve në kohëra e rrethana të ndryshme të ushqyera e nxitura nga ideologji të ndryshme. Ngjarje të tilla përkujtohen, vlerësohen, mbahet qëndrim dhe nuk kthehen në objekt urrejtje e armiqësie mes brezave që nuk i lidhje as gjë heroizmat as herezitë e të parëve të tyre.

**Prele Milani**

◀ Dëshiroj në mënyrë më të sinqertë t'i them dy fjalë mbi marrëdhëniet e mia gjatë kërkimeve në tokën e bekuar të Italisë në këto 10 vitet e fundit në institucionet dhe arkivat e ndryshme. Jam i lidhur shpirtërisht me historinë, pasion ky që e ka zanafillën tek mangësitë e shumta historike që ka historiografia shqiptare. Kështu, fillova kërkimet në arkivin e Venecias, Padovas, Loretos, Fermos, Grotaferratës, Napolit dhe të katër burimeve historike në Vatikan, përkatesisht Arkivi i Propagandës Fide, Arkivi Jezuit, Arkivi Sekret dhe Bibliotekës Apostolike.

Për aq sa kam arritur me flijime e mund të madh, duke vënë në dispozicion anën time fizike, profesionale dhe financiare, shfrytëzoj rastin nga kjo foltore që ti falënderoj dhe t'i përsëndes nga zemra të gjitha këto institucione. Respekti i tyre

ndaj meje, ndihma e pakursyer në çdo çast pa asnjë pengesë e rezervë për çdo dokument, dorëshkrim, sqarim, komunikim, ballafaqim, shpjegim, kanë qenë një motiv i fortë vazhdimësie në kërkimet e mia në zbardhjen, deshifrimin shënimitin e qindra e qindra dokumenteve që "flinin" nëpër arkiva.

Ju them sinqerisht se midis jush ndjehem mirë, njëllor si në vendin tim, në Shqipëri.

Marrëdhëniet kaq të ngrohta dhe miqësore midis Bashkive të qyteteve Maçerata dhe Fermo, por dhe të qyteteve të tjera, dhe emigrantëve nga Shqipëria të integruar tashmë në jetën ekonomike, kulturore, politike dhe sociale, me organet zyrtare shtetërore dhe me biznesmenët dhe popullin e kësaj zone flasin qartas për një bashkëpunim të sinqertë dhe vëllazëror nga të dyja palët.

Krijimi i shoqatave të ndryshme nga shqiptarët që banojnë këtu dhe bashkëpunimi i të gjitha organeve shtetërore dhe joqeveritare italiane me këto shoqata, ka ndihmuar që ky bashkëpunim dhe kjo miqësi të përhapet edhe midis banorëve të mjaft qyteteve italiane me banorë të qyteteve shqiptare në vendin tim.

Kjo miqësi dhe ky bashkëpunim, është një garanci që miqësia midis popullit shqiptar dhe atij italian të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Bashkatdhetarët e mi që punojnë dhe jetojnë midis jush, duhet të jenë shumë mirënjohës për ndihmën tuaj dhe duhet ta kuptojnë mirë barrën e madhe të përgjegjësisë që kanë për kultivimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi duke u distancuar publikisht me ata që e cenojnë këtë miqësi dhe bashkëpunim, duke kryer krime ose shkelje ligjore, të cilat e dëmto-

jnë rëndë emrin e mirë të krijuar me punën dhe aktivitetin e tyre nga mijëra bashkatdhetarë tanët në këto tridhjetë vitet e fundit që jemi të pranishëm këtu.

Njëkohësisht dua të falënderoj në mënyrë personale, përfaqësuesit e Bashkisë së Maçerates dhe gjithë përfaqësuesit institucionalë që janë sot të pranishëm në këtë takim për vëmendjen dhe gatishmërinë e tyre për ringjalljen e këtij fakti historik, ku njihet publikisht prania dhe afrimi i dy popujve tanë që në lashtësi. Ju shpreh mirënjohjen time më të thellë për këtë nismë.

Falënderoj për zemërsisht edhe pjesëtarët e shoqatës Iliria në Maçerata, të cilët u bënë shkak dhe urë frymëzimi për të garantuar praninë time në këtë aktivitet domethënës dhe të bukur.

**Redaksia**

# Ermiri i gjithanshëm nuk është më në mesin tonë

Për ne, për gjithë bashkësinë shkodrane e dukagjinase, mëngjesi i 7 gushtit 2023 ka ardhur me një lajm shumë të hidhur! Ermir Lera, mësuesi, futbollisti e kleriku nuk jeton më nga një aksidental fatal, I cili i humbi jetën.

## Kush ishte Ermir Pal Lera?

Ermiri lindi me 2 mars 1989 në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan i krahinës së Pultit, i biri i Palit dhe Gjystes, bashkëshorti i Blerina Hasaj-Lera dhe baba i Anikes, Moisit dhe Emas; vëllai i Ermalit, axha i Noemit e Kejdit; kunati i Valmires.

Me Blerinën, në vitin 2011 kishte krijuar familjen.

Me arsim të larte, fakulteti i edukimit fizik, mësues në shkollën 9 vjeçare "Ndre Mjeda", futbollist i ekipit "Vllaznisë"

Ermiri ishte anëtar i pashkëputuri kishës Babtist Church dhe në mes të tjerave, Pastori Arben Bushgjokaj thekson: "... Ermiri ishte i dashur e i sjellshëm me të gjithë dhe në veçanti me njerëzit në situatë të pafavorshme ... Ai ishte bashkëshort shumë i përkushtuar, i dashur dhe i kujdesshëm për Blerina Lerën dhe babai i Antikes, Moisiut e Emas ... Ermiri ka pësuar një aksident me 28 korrik 2023, duke rënë me koke në tokë. Ai u dërgua menjëherë në spitalin ushtarak në Tiranë, në repartin e Traumës, dhe e ushtruan menjëherë në re-umination dhe u konstatuan dëmtime të rënde në tru. Ai luftoi për dhjetë ditë për të mbijetuar, por fatkeqësisht u nda nga jeta të hënën e mëngjesit të datës 7 korrik 2023".

Ermiri ishte anëtarë shumë i përkushtuar e organizatës "Shpresa për Botën", në të cilën ishte anëtar që në muajin nëntor 2022...

Drejtori rajonal "Shpresa për Botën" do të shprehë: "Ermiri ishte një figure e rëndësishme brenda organizatës sonë, duke shërbyer në detyrën e koordinatorit në Qendrën e Zhvillimit dhe në Qendrën e të Rinjve. Përpjekjet e tij të shumta dhe përkushtimi i tij i patundur kanë kaluar vijshëmërisht pritshmëri duke lanë gjurmë të thella. ... Është me krenari dhe mirënjohje të thellë, që ne njohim dhe nderojmë kontributet e pashlyeshme të Ermir Lerës në organizatën tonë"

Ermiri ishte dhe futbollisti përkushtuar. Trajneri i futbollit shkodrane theksonte: "... Ermiri, me një karriere të mëparshme si futbollist i "Vllaznisë", dhe në vijim një nga mësuesit e përkushtuar të lëndës së edukimit fizik në shkollën 9 vjeçare "Ndre Mjeda", me rihapjen e veprimtarive të futbollit në Shkodër, Ermir Lera u bë pjesë e "Vllaznisë", duke qenë një nga titullarët kryesorë të këtij ekipi".

Gazetari sportive Gac Marku, në mes të tjerave do të shkruante: "Trajneri Celulaj, drejtori sportiv Arben Xhaferi dhe presidenti Fisnik Barbulushi, e kishin projektuar Leren në planet e "Vllaznisë" së re të sezonit



Nga e majta në të djathtë: Blerina, Ermiri, Anika, Moisi, Ema

2023-2024, madje me një projekt shumë ambicioz për ta shpallur atë kampione. Por, pikërisht në momentin e duhur të fillimit të punës për sezonin e ri, vjen ky lajm tronditës, që ka befusuar një Shkodër të tërë, dhe së bashku me të edhe kolektivin e futsalit shkodrane, por së shumti familjen e tij, e cila humbi njeriun e afërt, djalin, prindin dhe bashkëshortin shembullor. ... Ndarja nga jeta iu preu këtë ëndërr Ermirit, por shokët e skuadrës dhe grupi drejtues i futsalit shkodrane do të luajnë edhe për Lerën që ta shpallin "Vllazninë" kampione"

Maraglen Zhivani do të shkruante: "Të gjithë sportdashësit shkodranë e mbajnë mend futbollistin Lera për lojën me mjaft grinte dhe golat e shënuar me ekipin e fut-

sallës së "Vllaznisë" në sezonin e kaluar, teksa ai ka qenë një ndër protagonistët kryesorë të ekipit kuqeblu në shumë prej sukseseve të arritura. Trajneri i "Vllaznisë", Bujar Celufaj, bashkë edhe me drejtuesit e tjerë të ekipit të futsalit, kishin një projekt serioz edhe për sezonin e ri me futbollistët e kësaj skuadre, pjesë e së cilës ishte edhe Ermir Lera, por fatkeqësisht ky projekt do të vazhdojë pa të. 34-vjeçari po lëvizte me një monopatinë në zonën e Parrucës në Shkodër teksa ka rënë në një gropë. Nga ky aksidenti Lera është përplasur në tokë në pjesën e pasme të kokës duke u dëmtuar rëndë dhe duke qëndruar për 10-të në reanimacionin e spitalit ushtarak në Tiranë derisa fatkeqësisht humbi jetën. Me këtë rast, televizioni STAR PLUS i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Lera për humbjen e njeriut të tyre të dashur."

Ne faqen zyrtare të shkollës 9 vjeçare "Ndre Mjeda" theksohej: "Me hidhërim të thellë KF "Vllaznia" Futsal mori vesh lajmin e ndarjes së parakohshme nga jeta të sportistit tonë Ermir Lera. Lajm i trishtueshëm jo vetëm për familjarët e tij, por për të gjithë ambientin sportiv të Shkodrës. Grupi drejtues së bashku me shokët e ekipit i janë pranë familjes Lera në këto momente të vështira. I përjetshëm



qoftë kujtimi i tij." "Mësuam sot për ndarjen e parakohshme nga jeta të kolegut tonë, mësuesit të edukimit-fizik Ermir Lera. E pabesueshme për të gjithë ne, që bashkë u mblodhëm në dreqën e fundvitit e uruam për pushime të mbara. Trishtim në këtë ditë me shi për humbjen tënde mik i mirë, me buzë në gaz si ti, i papërtueshmi e i apasionuari pas lëndës tënde. Ashtu siç kishe emrin le një emër të mirë në kolektivin tonë, fatkeqësisht për pak....Qofsh mirë me Zotin i dashur mësues Miri!", shkruhet në faqen zyrtare të shkollës 9 vjeçare, "Ndre Mjeda" Shkodër.

Portali, Veriut Sport, i shpreh ngushëllimet e sinqerta, familjes Lera për humbjen e njeriut të tyre të afërt, ekipit të Futsales "Vllazni" për humbjen e titullarit të tyre, si dhe kolektivit të Shkodrës 9 vjeçare "Ndre Mjeda" për humbjen e kolegut të tyre model në të gjitha drejtimet. Pushofsh në paqe, Ermir Lera!"

\*\*\*

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe redaksia e gazetës "Dukagjini", Palit e Gjystes (babës e nenës se Ermirit), bashkëshortes se tij, Blerinës, vajzave Antikes e Emas dhe djalit Moisit ju shprehim ngushëllimet me te sinqerta dhe mos ju takoftë ta harroni Emirin tuaj dhe të tonin!

Ermir Lera i përjetshëm kujtimi i Juaj! Lamtumire Ermir Lera dhe pushofshi në Paqe!

**Ndue Sanaj**

# Proteste në respekt të policit Afrim Bunjaku

Një grup të rinjsh, pjesë e Tifozëve Kuq e Zi, anëtarë të partive politike opozitare dhe shoqërisë civile, ndezën qirinj dhe përcollën mesazhe në nderim të policit të rënë në krye të detyrës, Afrim Bunjaku.

“Lavdi heroit Afrim Bunjaku”, “Gjaku s’falet” ishin disa nga mesazhet e shkruara në pankartat që mbanin pjesëmarrësit të cilët vlerësuan lart rolin dhe sakrificën e policit të vrarë në krye të detyrës, për të mbrojtur sovranitetin e Kosovës.

“Jemi mbledhur sot për t’i bërë homazhe heroit dhe për t’i thënë kujtdo që prek territorin tonë se do të marrë përgjigjen e merituar.” – u shpreh një nga të rinjtë.

Ata i bënë thirrje shtetit shqiptar të reagojë në këtë moment vendimtar. Bunjaku u vra të dielën në veri të Mitrovicës gjatë një sulmi me armë ndaj policisë nga një grup terroristësh serbë.

\*\*\*

Fjalët prekëse të vajzës së policit që u vra në veri të Kosovës: Të gjitha na i mësove, por si të jetojmë pa ty asnjëherë!

Vajza e rreshterit Afrim Bunjaku, Arbenita, e ka mbajtur një fjalë të shkurtër në mbledhjen përkujtimore.

Arbenita përlotur theksoi se tërë Kosova do ta kujtojë me dhimbje dhe me mall. “Heroi im, babai im, sa vështirë e kam të shkruaj për ty babai im, para kohës mbeta jetim, kurrë se kam besuar. Ika jote na la një plagë të madhe në zemër. Babi nuk e di si do të jetoj pa ty. Hyra brenda në shtëpi dhe ty nuk të pashë, e rëndë për mua, vendin tënd në shtëpi nuk e zëvendëson askush.

Të gjitha na mësove, por si të jetojmë pa ty asnjëherë. U flijove për këtë vend që ne dhe Kosova që të jemi krenar për



heroizmin tënd. Do të jemi krenar për ty, me mall dhe me dhimbje do të kujtojmë”, u shpreh Arbenita.

Ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Jashtëm Igli Hasani ishin të pranishëm në Samadrexhe të Vushtrrisë, në ceremoninë mortore të heroit Afrim Bunjaku.

Balla ka shprehur mirënjohjen për policin Afrim Bunjaku, i cili dha jetën në krye të detyrës. “Përlotje nderim për efektin e Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili dha

jetën në krye të detyrës. Samadregj Vushtri, KOSOVE!”

Bunjaku ndërroi jetë ditën e djeshme, pasi policia e Kosovës u sulmua nga 30 persona, teksa dy kolegë të tij mbetën të plagosur. Bunjaku u shpall sot “hero i kombit”, pasi dha jetën në detyrë për mbrojtjen e atdheut.

Redaksia



## KAFSHATA E URISË...

**"Sa peshon një fëmijë kapriçioz se era, ai i një peshon më shumë se gjithë toka" - Gianni Rodari**

Kisha kohë që udhëtoja me tren për në Milano, por ajo ditë më ka mbetur në kujtesë dhe nuk do të më çrënjoset kurrë nga mendja. Ndodhesha në stacionin e Milanos në Rogoredo dhe teksa prisja ardhjen e trenit, iu përkushtova leximit të një libri me poezi. Isha përqëndruar tek vargjet e mrekullueshme, teksa ndjeva se dikush më kapi nga bërryli. Ktheva kokën dhe pashë një djalë të zbehtë në fytyrë nga papastërtia, me flokë të shpushpuritur gjithë zbokth, rrobat e grisura e të palara, dhe sytë e tij, ato sy të cilët nuk do t'i harroj kurrë, sepse nuk do të mundën të më hiqen nga mendja. Nuk ishte nevoja të shikoja dorën e tij të shtrirë teksa priste disa të shkoqura; ishin pikërisht ato sy që ulërinin urinë e kushedi prej sa orëve e



**lot? Loti i një peshon më pak fëmijë të uritur**

pse jo të ditëve mendova me keqardhje të thellë. E pyeta sa vjeç ishte dhe si e kishte emrin?

- Aron, jam 9 vjeç, - m'u përgjigj shkurt, sikur dëshironte mos ta harxhonte frymën apo ato pak energji që i kishin mbetur. I dhashë

disa euro e vetëdijshme se nuk do ta ndryshonin aspak gjendjen e tij të mjerë, por gjithësesi do t'a shuanin urinë të paktën për disa ditë. Aron vështroi paratë, i preku sikur dëshironte të sigurohej nëse ishin të vërteta, i shtrëngoi fort në dorë e mbledhur grusht dhe i futi shpejt nën çorap. Më falenderoi me buzëqeshjen e tij fëmijërore, por të burrëruar njëkohësisht dhe pasi më përshëndeti, vijoi drejt parkut.

- Aron! - e thirra në çast. Ai ktheu kokën dhe u kthye për të ardhur drejt meje.

- Merri këto! - i thashë teksa i zgjata

paninen e mbledhur në letër dhe shishen me ujë. Ai u përtypt pastaj e hapi rrëmbimthi letrën dhe kafshoi një copë. Teksa bëri ta kafshonte përsëri, u mendua një çast, hezitoi dhe e mblodhi përsëri në letër paninen. - Haje - i thashë, sapo e bleva.

- Do e ndaj me vëllezërit dhe motrën time, - m'u përgjigj duke ngritur supet.

- Janë të vegjël dhe kanë gjithmonë uri, - vazhdoi të më thoshte me zërin e tij fëmijërore teksa unë mendoja sesa i madh i dukej vetja dhe sa shumë ishte burrëruar para kohe nga skamja. Vështrova orën e dorës dhe teksa mendova se treni nisej pas gjysëm ore, i thashë:

- Eja me mua Aron! Ai ngriti kokën dhe bëri të më pyeste se ku do ta çoja.

- Shkojmë tek ky klubi këtu afër, të blejmë panine edhe për vëllezërit e motrat e tua, - iu përgjigja ëmbël.

- Kam paratë që më dhuruan zonjë, - më tha pa më lënë të mbaroja mirë.

- Eja! - i thashë. Ato përdori nesër!

Ai më ndoqi në heshtje dhe teksa prisja radhën, ndjeja vështimet e njerëzve, të cilët më shihnin me kuriozitet apo habi, dhe ndoshta pyesnin veten se çfarë donte ai djalë i varfër në shoqërinë time? Aq më bënte. Sikur shoqëria t'i zhdukte këto paragjykime, sikur varfëria të zhdukej nga planeti, sikur... më erdhi radha ndaj pyeta Aronin, realitetin që zhduku në çast

dëshirën "sikur", sa panine duhej të porosisja? - Pesë! - m'u përgjigj me gishtat e dorës. Porosita dyfishin, dhe teksa i lashë qesen në dorë, i buzëqesha dhe i thashë t'i çonte në shtëpi. Më falenderoi me buzëqeshje ndër sy dhe u largua. Teksa ecte, gati tërhiqte këmbët nga pafuqia, mendova se supet e tij, edhe pse ishte ende fëmijë, mbanin peshën e kohës së vështirë: skamjen.

E shoqërova me sy derisa u përzje me turmën e njerëzve dhe nxitova të marr trenin. Gjatë udhëtimit, nuk mendova gjë tjetër veç Aronit dhe vëllezërve e motrave të tij, të cilët i stërmundonte uria në këtë botë të ashpër dhe të padrejtë. Mendimi im gjithashtu u ndal në faktin se as mund të krahasohet bollëku dhe mirëqenia e fëmijëve tanë, me atë të Aronit dhe shumë fëmijëve të tjerëve kudo në botë. Rruzulli tokësor duhej të ishte njëloj për të gjithë: pa mjerim, pa luftëra, pa sëmundje, ashtu siç e krijoi Zoti dhe Natyra, por që njeriu e transformoi në planet shfrytëzimi.

\*Angela Kosta,

Shkrimtare, poetë, përkthyesë, publiciste dhe Zv. Kryeredaktore në Albania Press.

\*\*\* Poezi nga MARASH DELIA \*\*\* Poezi nga MARASH DELIA \*\*\*

Lindur në Alkun midis fshatit të Tales së Lezhës. Jeta e ti zhvillohet midis Lezhës, Laçit dhe Gjermanisë, sidomos në dekadat e fundit. Ka shërbyer në detyrën e shefit të Administratës pranë Këshillit të rrethit të Kurbinit, deri në 1994 kur është larguar nga Atdheu për kushte jetese më të mira. Ka mbaruar studimet për artin e Fotografisë së portretit njerzor në Gjermani ku ka punuar me Studion e ti disa vjet. Modestia e poetit thotë që: për mua le të flasin vargjet e mia.

\*\*\*

Ndalojeni shpërthimin e luftës atomike në Tokë! Ky planet nuk duhet të kthehet në shkretëtirë!!!

**Më tha malli...!**

Më tha malli: Mos më pyet, nëse brënda teje qajë, nëse lotë të derdhem syshë, e drithërija nëpër vajë...!

Nëse qajë gjer natën vonë rrugëve, nga ti udhëton... nëpër fatin tënd të trishtë, që larg yllit tënd na çonë...!

Më tha malli, mos më ndal, kur jashtë teje fluturojë, nuk kam faj, që digjem qiejve, si një rreze tek vi e shkojë...!

Më tha malli: Nuk kam faj, pse të mblidhem si lëmsh në fyt... tek ti na len kaq larg e larg... nuk kam faj, që ta zej frymën e të mbys...!

Më tha malli, mos më fajso, pse ty gjumin natën ta prish... tek shpërthej ëndrrash në lotë, dhe marr qiejtë e arratisë...!

Më thotë malli...!

**E ngrirë...!**  
- Legjenda e Marsit -

Ç'gabim kish bërë në qark të Kumtërit, nëpër njësi në të udhëtuar... një botë e ngrirë, një tokë e djegur... kafkash e eshtrash e shkrumbuar...!

Ndër oh-e dhëmbjesh seç u përflak... prej qiellit, zjarri, jo, nuk ju dha... por një "dorë" e gjatë, e gjithë mëkat... diç preku thellë dhe zjarri ra...!

Oh, dhe ngrinë kallkan nëpër vullkane, pasi u shkrinë, e tymit u thanë... tek kishin harruar me madhështoren; dashurinë e shenjtë, lënë mënjëanë...!

E rendën vesesh, në të pushtuar...

sundimit, shtypjes, verbërisë... tek dorë e gjatë, e pa ndaluar... e këputi fillin e dritë-perëndisë...!

Dhe ikën Engjëjt, për diku tjetër... në një botë të largët nëpër njësi... dhe mbet atje Marsi i djegur... si një ogur i zi ndër Galaksi...!

Dhe ajo "dorë", genesh e ngjizur... diku në një planet tjetër tashme stërzgjatet... Oh, të thella dhëmbjet, do të jenë... nëse dashurisë, fryma i ndalet...!

**Prelud për ty!**

Asnjë këngë asnjë melodi  
Nuk mund ti qetsojë dhëmbjet  
Që shkaktoj ikja jote e pa kohë,  
Oh po kush do të dëgjojë më  
Këngë apo melodi!

E ti atje së larti i ndjen gjamët  
I ndjen vajet dhe i sheh lotët,  
Tek nëpër ohe dihamash  
Pyesin qiellin; përse të zgodhi ty  
Që të merrte?

Ty, Nanë e Grua, zemër e shpirt  
I jetës që të thërret perjetë: O Nanë!

Ç'pjesë e Universit të mban në gji,  
Atje, prej nga ku ti tash na vështron  
Dhe e kupton se sa shumë të ka dashur  
Çdo njeri që të njohu ty në jetë!

Ndërsa unë pyes Qiellin përse ty?  
E jo mua që nëpër aq dhëmbje  
Frymtoj lotueshem akoma...!

Oh ç'fat mizor paskemi pasun!  
Do të dojsha të më përcillje ti  
Në ditën e fundit ashtu siç më përcolle  
Nëpër jetë gjurmë pas gjurme  
Në kohët e vështira e të mira,  
Në gjithçka që sot kujtohet me lot,  
Në ato zopëza jete  
Ku krijuam të ardhmen,  
E ardhmja të cilët me lot të kërkojnë  
Me sy drejt Qiellit duke të thirrur  
O Nanë!

O Nanë e Grua shenjtoje  
Që krijove jetë duke dhuruar shpirtin  
Me sakrificat mbi toksore  
Pa kërkuar asgjë për veten kurrë,

O ti qofsh e Parajsës Hyjnore  
Atje pranë Krishtit në Qiellin e Perëndisë!

Ndërsa u ndamë atje në tokën e Atdheut  
Për tu bashkuar një ditë përseri  
Si pjesë e asajë toke, prej nga ku  
Shpirtrat udhëtojnë drejt Qiellit!

Pushofsh në Paqë o mall i dhimbshem,  
O dhëmbja më e madhe e jetës time,  
Maraku dhe humbja më e rëndë,  
Ti Drita që të kërkoja udhëve  
Gjithmonë siç kërkon fëmija Nanën...!

**Nga unë për ty!**

Pa fjalë...!

Pa fjalë kanë mbetur ditët  
Me mëngjese e muzgje,  
Me mbrëmje e mesnata të ftohta  
Edhe pse pranverë është tani.

Pa fjalë kanë mbetur të gjitha  
Edhe dhëmbjet, mallet, kujtimet,  
Nën të akulltën ironi të heshtjes,  
Që s'ka më frymë të përgjigjet.

Pa fjalë ka mbetur dhe Hënëza  
Që gjithë mesnatave fliste me ne...  
Oh, moj Hënëz, ti fol me dritën tënde,  
Dhe ma fal buzëqeshjen tënde të re

Se vargje do të thur përseri,  
E ashtu në orbitën tënde të ndritshme

Do ta pres mesnatave perendimin  
Me atë mall që ma din vetëm ti!


**Fund Qershori...!**

Shkoj dhe Qershori i kësaj Vere,  
Lulet nëpër parqe po vishken ngadalë,  
Ndërsa udhët heret u boshatisën,  
S'ka më si dikur aq shumë kalimtarë.

Ah, e ftohta mesnatë po afron  
Edhe pse Verë është dhe bën zagushi,  
Veç yjet nëpër Qiell ndriçojnë,  
Si Dimër duken netët në vetmi.

Shkojë dhe Qershori sivjet,  
Kjo Verë si e shkretë këndeje në veri,  
Symallet përumben mesnatës së vonë  
Nëpër hapsirat qiellore gjer në njësi.

Avionë nuk ka,  
As trenat nuk ndihen të vinë,  
Oh, eja ti moj Hënëzo,  
O mall i shpirtit tim!



**REDAKSIA**

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:

**PROF.DR. VUKSAN KOLA**

